



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMPANISË REGJIONALE TË MBETURINAVE "UNITETI" SH.A. PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, prill 2026

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" sh.a. për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kundërt për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" sh.a. (KRM "Uniteti" sh.a.), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2025, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjes/ve së përshkruar në paragrafin "Baza për Opinion të Kundërt", Pasqyrat Financiare të bashkangjitura nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" sh.a. deri me 31 dhjetor 2025, të performancës së saj financiare, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2025, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

## Baza për Opinion të kundërt

- B1 Kompania kishte të regjistruara në regjistrin e saj katër parcela me vlerë 1,378,000€, të cilat nuk janë as në pronësi dhe as në shfrytëzim të saj, dhe katër objekte me vlerë neto prej 97,500€, të cilat sipas dëshmimeve përkatëse, janë rrënuar në vitin 2021 dhe si të tilla nuk ekzistojnë më. Ndërsa, nuk e kishte regjistruar në regjistrin e pasurisë sipërfaqen e dhënë në shfrytëzim nga Komuna e Mitrovicës vite me parë, të cilën kompania e shfrytëzon si deponi për menaxhimin e mbeturinave.
- B2 Kompania në pasqyrat vjetore financiare kishte prezantuar llogaritë e arkëtueshme në vlerë neto prej 4,161,172€. Kompania nuk kishte kryer analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga konsumatorët dhe nuk kishte njohur fare provizione vjetore për llogaritë e arkëtueshme që nga viti 2018.
- B3 Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme nuk është efektiv, pasi kompania vazhdon të mbajë në regjistra 3,471,205 € borxhe të pa arkëtueshme, prej të cilave 1,648,883 € borxhe të vjetra para vitit 2017 për klientët e Mitrovicës, 1,484,742 € për klientët e Vushtrrisë që nuk menaxhohen më nga kompania dhe 337,580 € për klientë pasivë në njësitë Mitrovicë dhe Skenderaj. Po ashtu, regjistri i llogarive të arkëtueshme nuk është i plotë, pasi borxhet e 10 klientëve në vlerë prej 118,622€ nuk janë të përfshira në regjistër dhe, rrjedhimisht, as në pasqyrat financiare.
- B4 Të hyrat e shtyra nga grantet ishin prezantuar në vlerë 303,120€, ndërsa testimet tona tregojnë se vlera e prezantuar ishte nënvlerësuar për 324,810€. Si rrjedhojë, edhe të hyrat tjera të prezantuara në pasqyrën e të ardhurave ishin nënvlerësuar për 50,280€.

- B5 Korrigjimet e bëra në Zërin "Rezervat Tjera" në shumën totale prej 1,531,455€ nuk janë dokumentuar dhe as nuk janë arsyetuar përlllogaritjet që kanë çuar në realizimin e këtyre ndryshimeve.
- B6 Keqprezantim i detyrimeve tatimore ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) në vlerë prej 469,887€, si rezultat i nënvlerësimit të tyre në regjistrat kontabël.
- B7 Në pasqyrën e rrjedhës së parasë, ndërmarrja kishte përfshirë vlera që nuk përfaqësojnë rrjedha reale të parasë, konkretisht 40,630€ të evidentuara si rritje në detyrimet tjera, që paraqesin ndryshimin në fitimin e mbajtur, si dhe 205,999€ të evidentuara si ndryshime tjera në ekuitet, që paraqesin ndryshimin në zërin "rezervat tjera". Këto ndryshime janë diferencë ndërmjet gjendjes së vitit 2025 dhe vitit 2024.
- B8 Shpenzimet operative në pasqyrat financiare ishin nënvlerësuar për 16,336€ krahasuar me shënimet kontabël. Ndërsa, shpenzimet për polisa sigurimi në vlerë prej 5,280€ dhe pagesa prej 1,468€ për depozitë sigurie janë trajtuar gabimisht si shpenzim, duke ndikuar në mbivlerësim të shpenzimeve.
- B9 Prezantimi i llogarive të pagueshme tregtare në pasqyrat financiare nuk ishte i saktë, pasi nuk ishin përfshirë dy fatura në vlerë 12,879€.
- A1 Shpenzimet e pagave të raportuara në pasqyrat financiare (1,387,989€) nuk përputhen me ato të deklaruara në ATK (1,394,256€), me një diferencë prej 6,267€.
- B10 Janë identifikuar pasaktësi në trajtimin e të hyrave, përfshirë korrigjime të viteve të kaluara në vlerë prej 25,985€ të reflektuara në vitin aktual, trajtimin e kthimit të akontacioneve në vlerë prej 3,550€ si zvogëlim i të hyrave, si dhe njohjen e të hyrave në vlerë prej 3,497€ në periudha jo përkatëse.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë të pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

**Konkluzion për pajtueshmërinë**

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të Kompanisë Regjionale të Mbeturave "Uniteti" sh.a. kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

- A2 Gjatë auditimit është konstatuar se, ndonëse në planin e prokurimit për vitin 2025 ndërmarrja kishte paraparë zhvillimin e një procedure të vetme për "Furnizim me pjesë për automjete" në vlerë 300,000€, gjatë vitit janë zhvilluar dy procedura të ndara për të njëjtin furnizim.
- A3 Bordi i Drejtorëve i ka ndarë vetes bonus në vlerë 5,760€, pa miratim nga Aksionari.
- B11 Kompania nuk ka të vendosur në mënyrë të duhur sistemin e kontrollit të brendshëm, pasi funksionon pa zyrtar për auditim të brendshëm, nuk ka rregullore për menaxhimin e pasurisë, politika dhe procedura kontabël, si dhe rregullore të pa azhuruara dhe të paplota. Gjithashtu, mungon lista e proceseve dhe regjistri i rreziqeve. Po ashtu, kompania nuk ka përmbushur kërkesat ligjore për raportim, pasi nuk ka përgatitur dhe miratuar në kohë raportet tremujore dhe raportin vjetor, në përputhje me afatet e përcaktuara me Ligjin për Ndërmarrjet Publike.
- B12 Realizimi i pagesave të drejtëperdrejta në vlerë 42,063€ në emër të kontributeve pensionale për punonjës të cilët tashmë kanë dalë në pension në kundërshtim me Ligjin nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës.
- B13 Kompania nuk ka përgatitur një regjister të detajuar të pasurive, i cili duhet të përfshijë të gjitha kërkesat e rregullores së brendshme për zbatimin e procedurave dhe politikave afariste. Për më tepër, pasuritë nuk mbahen në softuer të kontabilitetit por në Excel, nuk kanë numër inventarizues dhe një pjesë e pasurisë janë të regjistruar në grup.
- B14 Kompania kishte realizuar pagesa nën 100€ në vlerë totale 11,162€, ndaj operatorëve ekonomik pa ndjekur procedura të prokurimit dhe pa dokumentacion justifikues që do të arsyetonte përdorimin e ndonjë përjashtimi ligjor.
- C1 Kompania për gjashtë pozita të njëjta, nuk kishte paguar punonjësit me grada ose nivele të barabarta, pavarësisht se kryejnë të njëjtat detyra dhe kanë përshkrim të njëjtë të pozitës.
- C2 Inventarizimi i pasurive në fund të vitit nuk është realizuar në mënyrën e duhur nga komisioni për inventarizim, pasi që nuk janë evidentuar 19 automjete që figurojnë në regjistrin e pasurive dhe nuk është dhënë asnjë shpjegim lidhur me mungesën e tyre gjatë procesit të inventarizimit.

*Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" sh.a..

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" sh.a. është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" sh.a. në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>2</sup>

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të KRM "Uniteti" sh.a - Mitrovicë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Kompanisë Regjionale të Mbeturave "Uniteti" sh.a..
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruar të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Kompanisë Regjionale të Mbeturave "Uniteti" sh.a., për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 23 rekomandime, prej tyre tre janë rekomandime të reja, 17 të përsëritura dhe tre pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Dobësi në menaxhimin e pasurive si dhe mungesë e përditësimit të regjistrit të pasurisë

##### Gjetja

SNK 16 - Aktivitet Afatgjatë Materiale, në paragrafin 7, thekson se kosto e një zëri të aktiveve afatgjatë materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) do të njihen si aktiv nëse është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin tek njësia ekonomike dhe kosto e aktivitetit mund të matet me besueshmëri. Ndërsa paragrafi 50 thekson se shuma e amortizueshme e një aktivi do të shpërndahet mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme.

Gjatë procesit të auditimit kemi identifikuar dobësi në menaxhimin e pasurisë, si dhe mungesë të përditësimit të regjistrit të pasurive, të cilat janë paraqitur në vijim:

- Në pasqyrën e pozicionit financiar, në kuadër të zërit "Pasuritë afatgjata", kompania kishte përfshirë vlerën e tokave 1,378,000€, e cila përbëhej nga tri parcela në Komunën e Vushtrrisë me vlerë totale 719,000€ dhe një parcelë në Komunën e Skenderajt me vlerë 659,000€. Sipas dokumentacionit përkatës, këto parcela nuk janë në pronësi dhe as në shfrytëzim nga kompania
- Kompania nuk e kishte regjistruar në regjistrin e pasurisë sipërfaqen e dhënë në shfrytëzim vite më parë nga Komuna e Mitrovicës, të cilën kompania e shfrytëzon si depo për menaxhimin e mbeturinave.
- Sipas raportit të rivlerësimit të pasurive të vitit 2021, përveç objektit që ndodhet selia e kompanisë në Mitrovicë, kompania kishte pranuar në shfrytëzim edhe sipërfaqen në të cilën gjendet objekti. Kjo hapësirë nuk ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë.
- Në regjistrin e pasurisë figuronin katër ndërtesa me vlerë totale 97,500€. Sipas dokumenteve zyrtare, këto objekte ndodheshin në Komunën e Skenderajt, por me vendim të komunës ato ishin rrënuar në vitin 2021 dhe, si të tilla, nuk ekzistojnë më.
- Me datë 06.07.2023, kompania kishte nënshkruar një marrëveshje me Komunën e Mitrovicës për marrjen në shfrytëzim të një automjeti (Kamion Kompaktor 8m<sup>3</sup> IVEKO - viti i prodhimit 2023). Edhe pse është në përdorim, ky automjet nuk ishte regjistruar në regjistrat e pasurive të kompanisë.
- Tutje, në regjistrin e pasurive të kompanisë është i përfshirë një kamion (Mercedes Benz Atego 1524, viti 2022) me vlerë 59,600€. I njëjti, sipas sqarimeve të kompanisë, me rastin e shuarjes së njësisë së Vushtrrisë nuk është transferuar në kompani, pasi që ka qenë pronë e Komunës së Vushtrrisë dhe si rrjedhojë nuk është në shfrytëzim dhe as në pronësi të kompanisë.
- Gjithashtu, një pasuri është prezantuar gabimisht në pasqyrat financiare me diferencë prej 3,281€, si rezultat i gabimeve në kalkulimin e zhvlerësimit, duke rezultuar në nënvlerësim të vlerës së pasurive.

Mangësitë e identifikuar kanë ardhur si rrjedhojë e dobësive në sistemin e kontrollit të brendshëm në menaxhimin e pasurive, përfshirë mungesën e verifikimit periodik të statusit juridik dhe fizik të pasurive, mungesën e përgjegjësive të qarta për regjistrimin dhe përditësimin e tyre, si dhe mungesën e harmonizimit ndërmjet regjistrit të pasurive dhe gjendjes reale. Po ashtu, mungesa e mbikëqyrjes menaxheriale ka ndikuar në mosidentifikimin me kohë të pasaktësive. Për më tepër, përdorimi i mjeteve manuale pa kontrole të integruara, ka rritur rrezikun për gabime në regjistrim, zhvlerësim dhe raportim të pasurive.

## Ndikimi

Mospërditësimi i regjistrit të pasurive me gjendjen aktuale të pasurive përveç që ndikon që vlera e pasurive të kompanisë të mos pasqyrohet në mënyrë të drejtë dhe të saktë në pasqyrat financiare rrit rrezikun që pasuritë të ekspozohen ndaj humbjes apo keqpërdorimit. Po ashtu, gabimet në kalkulimin e zhvlerësimit ndikojnë në keq prezantimin e pasurisë afatgjatë, duke rezultuar në pasqyrim jo të drejtë të pozicionit financiar të kompanisë.

**Rekomandimi B1** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që kompania të ndërmarrë një verifikim të plotë juridik dhe fizik të të gjitha pasurive, me qëllim identifikimin e saktë të pasurive në pronësi dhe në shfrytëzim, si dhe të bëjë çregjistrimin e pasurive që nuk i përkasin kompanisë të mbështetura me dokumentacion përkatës. Po ashtu, të caktohen përgjegjësi të qarta për administrimin dhe përditësimin e tij, si dhe të implementohet një sistem i automatizuar për menaxhimin e pasurive, përfshirë kalkulimin e saktë të zhvlerësimit, me qëllim raportimin e saktë financiar.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B2 - Mos provizionim i llogarive të arkëtueshme tregtare**

##### **Gjetja**

Standardi Ndërkombëtar për Raportim Financiar 9 (SNRF) Instrumentet financiare në paragrafin B5.5.35 sqaron se entiteti mund të llogaris humbje të pritshme të kredisë për llogaritë e arkëtueshme tregtare duke përdorur një matricë provizionesh. Entiteti do të përdorë përvojën e saj historike për të vlerësuar humbjet e pritshme të kredisë për periudhën 12-mujore ose humbjet e pritshme të kredisë për tërë jetën e aktivitetit financiar. Në varësi të larmisë së klientëve të saj, entiteti do të përdor grupimet e përshtatshme në qoftë se përvoja e saj historike e humbjeve të kredisë tregon modele të ndryshme humbjeje për segmente të ndryshme të klientëve.

Në pasqyrat financiare të vitit 2025, kompania kishte prezantuar llogaritë e arkëtueshme në vlerë neto prej 4,161,172€. Ndërmarrja nuk kishte kryer analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga konsumatorët dhe nuk kishte njohur fare provizione vjetore për llogaritë e arkëtueshme që nga viti 2018. Prandaj, mungesa e aplikimit të lejimeve/provizionimeve ndër vite ndikon që vlera bartëse neto e llogarive të arkëtueshme tregtare në PVF të mos jetë e saktë.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte hartuar asnjë politikë për provizionimin e llogarive të arkëtueshme dhe, si rrjedhojë, nuk e kishte trajtuar këtë çështje si prioritet në proceset financiare për disa vite me radhë.

##### **Ndikimi**

Mos përfshirja e provizioneve për të arkëtueshmet e dyshimta në pasqyra financiare, ndikon në mbivlerësim të llogarive të arkëtueshme (pasurive) dhe rritë rrezikun për vendimmarrje të bazuar në të dhëna të pasakta.

##### **Rekomandimi B2**

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që kompania të hartojë dhe zbatojë një politikë për provizionimin e llogarive të arkëtueshme duke përfshirë klasifikimin e tyre sipas vjetërsisë, kategorisë së klientëve dhe historikut të pagesave, si dhe aplikimin e një metode të përshtatshme për llogaritjen e humbjeve të pritshme. Po ashtu, duhet të bëhet njohja e provizioneve dhe të sigurohet dokumentimi i vlerësimeve para miratimit të pasqyrave financiare.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B3 - Mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme****Gjetja**

Sipas Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12.1, kërkohet që Shoqëritë tregtare të verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmime të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël. Ndërsa, Ligji Për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr. 04/L-077 në nenin 360 përcakton se kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake, parashkruhen pas një (1) viti.

Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme është karakterizuar me dobësi të theksuara ndër vite, të cilat janë paraqitur si më poshtë:

Njësia Mitrovicë - Në regjistrin e llogarive të arkëtueshme ekzistojnë 3,835 klientë që kanë borxhe ndaj kompanisë në vlerë prej 1,648,883€. Në vitin 2017, Komuna e Mitrovicës kishte marrë në menaxhim procesin e faturimit dhe inkasimit dhe kishte pranuar këta klientë me saldo zero, pa bartur borxhet ekzistuese. Ndërsa, në vitin 2022, menaxhimi i këtij procesi kishte kaluar përsëri te kompania, e cila nuk i kishte përdorur kartelat ekzistuese, por kishte hapur kartela të reja për klientët me saldo zero. Si rrjedhojë, borxhet e akumuluar para këtij procesi kanë mbetur të evidentuara në kartelat individuale të vjetra, pa u alokuar në kartelat aktive të klientëve.

Po ashtu, në këtë njësi figurojnë 318 klientë pasivë (subjekte të mbyllura) me borxh total prej 191,536€, për të cilët nuk janë ndërmarrë masa ligjore apo administrative për mbledhjen e borxhit.

Njësia Skenderaj - Në regjistrin e ndërmarrjes figurojnë 732 klientë pasivë me borxh total prej 146,044€, për të cilët nuk janë ndërmarrë veprime për mbledhjen e borxhit.

Njësia Vushtrri - Kompania vazhdon të mbajë në regjistrat e saj 5,874 klientë me borxh total prej 1,484,742€, ndonëse kjo njësi është ndarë dhe klientët e saj kanë kaluar nën menaxhimin e një kompanie tjetër në Komunën e Vushtrrisë pa përfshirë borgjet e akumuluar. Aktualisht, këta klientë nuk faturohen më nga kompania dhe nuk janë ndërmarrë veprime për inkasimin e borxhit, megjithatë borxhi vazhdon të figurojë në librat kontabël të saj.

Tutje, gjatë rishikimit të kartelave analitike të klientëve në kuadër të auditimit të të hyrave, janë identifikuar 10 klientë me borxh në vlerë totale prej 118,622€, të cilët figurojnë në kartelat analitike, por nuk janë përfshirë në regjistrin e llogarive të arkëtueshme.

Mangësitë e identifikuar janë rezultat i dobësive në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe bartjes së saldove nga viti në vit pa një analizë të mirëfilltë. Mungesa e veprimeve ligjore për inkasimin e borxheve është arsyetuar me gjendjen jo të mirë financiare të kompanisë dhe koston e lartë të procedurave përmbartimore. Për më tepër, mangësitë në plotësinë e regjistrin të llogarive të arkëtueshme lidhen me mungesën e kontrolleve efektive, rishikimit të rregullt të të dhënave dhe harmonizimit ndërmjet kartelave të klientëve dhe regjistrin të llogarive të arkëtueshme.

**Ndikimi** Mungesa e kontrolleve adekuate në sistemin e kontabilitetit dhe mos harmonizimi periodik i të dhënave ndërmjet kompanisë dhe klientëve ndikojnë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyrat financiare. Po ashtu, mos ndërmarrja e veprimeve ligjore për inkasimin e borxheve rrit rrezikun e humbjeve financiare dhe vështirëson përmbushjen e detyrimeve financiare. Për më tepër, mos përfshirja e klientëve me saldo debitore në regjistrin e llogarive të arkëtueshme cenon besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe mund të jetë çorientuese për lexuesit e tyre.

**Rekomandimi B3** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që kompania të ndërmarrë një vlerësim të plotë të regjistrin të llogarive të arkëtueshme, me qëllim përcaktimin e statusit dhe bazës ligjore për secilin borxh, përfshirë veçanërisht borxhet e njësisë së Vushtrrisë dhe ato të vjetra. Në bazë të këtij vlerësimi, kompania duhet të ndërmarrë trajtimin e duhur kontabël dhe ligjor të këtyre borxheve, si dhe të sigurojë përfshirjen e plotë dhe të saktë të të gjitha saldove në regjistrin. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollet përmes barazimeve periodike dhe të ndërmerren veprime për inkasimin e borxheve, me qëllim sigurimin e një paraqitjeje të drejtë dhe të besueshme në pasqyrat financiare.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B4 - Prezantimi jo i saktë i të hyrave të shtyra nga grantet**

**Gjetja** Sipas SNK 20 neni 24, grantet që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, duhet të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar duke njohur grantin si të ardhur të shtyrë. Për më tepër, grantet e marra për aktive të amortizueshme njihen si të ardhura gjatë periudhave në të cilat ngarkohet zhvlerësimi për ato pasuri.

Në bilancin e gjendjes kompania kishte njohur "Të hyrat e shtyra nga grantet" në vlerë prej 303,120€. Ne kemi identifikuar në kuadër të këtij zëri nuk janë përfshirë dy pasuri në vlerë 324,810€, që vite më parë i janë dhënë kompanisë në shfrytëzim nga Komuna e Mitrovicës.

Si rezultat, edhe zëri "Të hyrat tjera" në pasqyrën e të ardhurave është paraqitur i pasaktë, pasi është raportuar në vlerë prej 151,560€, ndërsa sipas përlllogaritjeve tona do të duhej të ishte 201,840€, duke përfshirë zhvlerësimin vjetor të këtyre dy pasurive. Rrjedhimisht, pasaktësia në raportim për këtë zë është në vlerë prej 50,280€.

Mos përfshirja e të gjitha pasurive të pranuar si grant në kuadër të të hyrave të shtyra ka ndodhur si pasojë e gabimeve gjatë përditësimit të regjistrin të pasurive të pranuar si grant.

**Ndikimi** Mos përfshirja e të gjitha pasurive të pranuar si grant ka ndikuar që grantet të mos prezantohen saktë në bilancin e gjendjes dhe njohje jo të plotë të të hyrave në pasqyrën e të ardhurave.

**Rekomandimi B4** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që kompania të identifikojë dhe regjistrojë të gjitha pasuritë e pranuar si grant dhe të sigurohet rishikim i rregullt i këtyre zërave para miratimit të pasqyrave financiare, me qëllim paraqitjen e drejtë dhe të plotë në PFV.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B5 - Ndryshimi i vlerës së rezervave të tjera pa shpjegime të dokumentuara në pasqyrat financiare****Gjetja**

SNK 16 - Aktivet afatgjata materiale: - paragrafi 39, përcakton që, nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi rritet si rezultat i një rivlerësimi, rritja do të njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe akumulohet tek kapitalet e veta me titullin tepricë rivlerësimi. Megjithatë, rritja njihet në fitim ose humbje për aq sa kjo mbulon uljen e rivlerësimit të të njëjtit aktiv të njohur më parë në fitim ose humbje. Po ashtu - paragrafi 40, përcakton, nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi ulet si rezultat i një rivlerësimi, ulja njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, ulja do të njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për aq sa kjo mbulon çdo tepricë kreditore ekzistuese në tepricën e rivlerësimit në lidhje me atë aktiv. Rënia që njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, zvogëlon shumën e akumuluar në kapital në zërin, tepricë nga rivlerësimi.

Në pasqyrat financiare të vitit 2023, zëri “Rezervat tjera” ishte paraqitur në vlerën 2,849,112€, ndërsa në pasqyrat e vitit 2024 kompania kishte bërë korrigjime të kësaj vlere. Për vitin 2023 ishte bërë një korrigjim retrospektiv, ku vlera e rezervave është ulur nga 2,849,112€ në 1,317,657€, ndërsa për vitin 2024 rezervat tjera ishin paraqitur në vlerën 1,523,656€, që tregon një rritje prej 205,998€ krahasuar me vitin e mëparshëm të korrigjuar.

Në pasqyrat financiare të vitit 2025, ky zë është kthyer përsëri në vlerën 1,317,657€, ndërsa për vitin 2024 nuk është reflektuar asnjë korrigjim përkatës. Kompania nuk ka ofruar sqarime lidhur me arsyen e paraqitjes së vlerës 1,523,656€ për vitin 2024, dhe as për rikthimin e rezervave në vlerën paraprake (1,317,657€) në vitin 2025.

Për këto ndryshime nuk është ofruar asnjë shpjegim apo dokumentacion mbështetës që do të arsyetonte rritjen ose uljen e rezervave brenda viteve. Si rrjedhojë, paraqiten lëvizje të paarsyetuara në kapital, pa bazë të verifikueshme, duke krijuar paqartësi mbi saktësinë dhe qëndrueshmërinë e këtij zëri në pasqyrat financiare.

Kjo situatë ka ndodhur si rrjedhojë e mungesës së rishikimit dhe kontrollit të mjaftueshëm gjatë përgatitjes dhe miratimit të pasqyrave financiare, përfshirë mungesën e dokumentimit të korrigjimeve dhe ndryshimeve në këtë zë të kapitalit, si dhe mungesën e mbikëqyrjes menaxheriale mbi këto lëvizje.

**Ndikimi**

Mungesa e rishikimit, kontrollit dhe dokumentimit të ndryshimeve në zërin “Rezervat tjera” ka ndikuar negativisht në transparencën dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare. Si rrjedhojë, këto lëvizje në kapital nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të verifikueshme, duke rezultuar në prezantim të pasaktë të pozitës financiare të kompanisë dhe të pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet.

**Rekomandimi B5** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që kompania të ndërmarrë një rishikim të plotë të zërit "Rezervat tjera", me qëllim analizimin e të gjitha lëvizjeve dhe përcaktimin e bazës së dokumentuar për çdo ndryshim. Po ashtu, duhet të sigurohet që të gjitha korrigjimet, përfshirë ato retrospektive, të mbështeten me dokumentacion përkatës dhe të jenë në përputhje me standardet përkatëse, si dhe të bëhet shpalesje e plotë e këtyre ndryshimeve në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B6 - Keqprezantim i detyrimeve tatimore ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) si rezultat i nënvlerësimit të tyre në regjistrat kontabël**

**Gjetja** Sipas Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12.1, kërkohet që Shoqëritë tregtare të verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmime të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.

Kompania në kuadër të detyrimeve afatshkurtra në pasqyrën e pozicionit financiar kishte prezantuar detyrime tatimore në vlerë 3,906,203€, ndërsa bazuar në gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve të tatimpaguesit, si dhe në konfirmimet e pranuar nga ATK, detyrimet totale tatimore janë 4,376,090€, përfshirë dënimet dhe interesat. Si rrjedhojë, detyrimet tatimore janë nënvlerësuar për 469,887€, duke rezultuar në keqprezantim të këtij zëri në pasqyrat financiare për vitin 2025.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos harmonizimit ndër vite të detyrimeve tatimore të kompanisë me gjendjen e deklarimeve dhe detyrimeve në ATK. Po ashtu, mungesa e rishikimit dhe mbikëqyrjes menaxheriale ka bërë që këto dallime të mos identifikohen dhe korrigjohen me kohë.

**Ndikimi** Mos barazimet periodike kanë ndikuar që këto detyrime të paraqiten më të ulëta se sa janë realisht në pasqyrat financiare, duke ndikuar në prezantim jo të saktë të pozitës financiare të kompanisë. Po ashtu mos pagesa e detyrimeve tatimore dhe pensionale, rritë rrezikun që të aplikohen ndëshkime nga autoritetet tatimore për mos pagesë të detyrimeve në afatin kohor.

**Rekomandimi B6** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që kompania të kryejë barazime periodike të detyrimeve tatimore me gjendjen në ATK, dhe të reflektojë saktë këto detyrime në pasqyrat financiare bazuar në gjendjen e konfirmuar. Po ashtu, kompania duhet të hartojë dhe zbatojë një plan për trajtimin dhe pagesën e detyrimeve të akumuluar.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B7 - Mos prezantim i saktë i pasqyrës së rrjedhës së parasë së gatshme****Gjetja**

SNK 1 - Paraqitja e pasqyrave financiare, një njësi ekonomike duhet të përgatisë pasqyrat financiare të saj, me përjashtim të informacionit mbi rrjedhën e parasë, mbi bazën e kontabilitetit rritës. Qëllimi i pasqyrës së rrjedhës së parasë, sipas SNK 7, është për të plotësuar nevojat e përdoruesve të informacionit kontabël në lidhje me rezultatin monetar, me fluksin e lëvizjes së mjeteve monetare gjatë një periudhe kontabël. Ndërsa në nenin 17 të këtij standardi përcaktohet që dhënia e informacioneve të veçanta shpjeguese për flukset monetare që krijohen nga veprimtaritë financiare është e rëndësishme, pasi ato shërbejnë për parashikimin e kërkesave për fluksin monetar të ardhshëm nga ofruesit e kapitalit për njësinë ekonomike.

Në pasqyrën e rrjedhës së parasë, ndërmarrja në seksionin e ndryshimeve në pasuri dhe detyrime operative kishte prezantuar si rritje në detyrimet tjera vlerën 40,630€, e cila në fakt paraqet diferencën ndërmjet fitimit të mbajtur për vitin 2025 dhe atij të vitit 2024. Ndërsa në seksionin e rrjedhës së parasë nga aktivitetet financuese, ishte prezantuar vlera prej 205,999€ si ndryshime tjera në ekuitet, e cila paraqet ndryshimin në zërin “rezervat tjera” ndërmjet vitit 2025 dhe vitit 2024. Sipas kërkesave të standardeve kontabël për pasqyrën e rrjedhës së parasë (SNK 7), ndryshimet në zërat e kapitalit si fitimi i mbajtur dhe rezervat tjera nuk përfaqësojnë rrjedha reale të parasë dhe, rrjedhimisht, nuk duhet të përfshihen në pasqyrën e rrjedhës së parasë.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së rishikimit dhe kontrollit cilësor gjatë përgatitjes së pasqyrës së rrjedhës së parasë, përfshirë mungesën e verifikimit të saktësisë së klasifikimit të rrjedhave monetare, si dhe mungesën e mbikëqyrjes nga nivelet përgjegjëse.

**Ndikimi**

Mangësitë dhe pasaktësitë në pasqyrën e rrjedhës së parasë, ndikojnë më kredibilitetin e pasqyrave financiare në tërësi.

**Rekomandimi B7**

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që kompania të rishikojë metodologjinë e përgatitjes së pasqyrës së rrjedhës së parasë, me qëllim sigurimin e klasifikimit të saktë të rrjedhave monetare. Po ashtu, duhet të vendoset një kontroll i veçantë dhe rishikim i detajuar i kësaj pasqyre para miratimit të pasqyrave financiare.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B8 - Mos prezantimi i drejtë i shpenzimeve në Pasqyrat Vjetore Financiare****Gjetja**

SNK1, paraqitja e pasqyrave financiare, në nenin 15 përcakton se pasqyrat financiare do të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në kuadrin konceptual për raportimin financiar.

Kompania në pasqyrën e të ardhurave kishte prezantuar shpenzimet operative në shumë prej 405,081€<sup>1</sup>, ndërsa sipas shënimeve kontabël ato ishin 421,411€<sup>2</sup>, duke rezultuar me një diferencë prej 16,336€. Kjo diferencë ishte rezultat i nënvlerësimeve dhe mbivlerësimeve në kategori të ndryshme të shpenzimeve, duke reflektuar mungesë konsistence dhe saktësie në regjistrimin e tyre.

Përveç kësaj, Kompania ka njohur në tërësi si shpenzim faturat për polisa sigurimi në vlerë prej 8,879€, pa marrë parasysh periudhën që ato mbulojnë. Meqenëse një pjesë e tyre i përket periudhave të ardhshme, shuma prej 5,280€ do të duhej të trajtohej si parapagim dhe jo si shpenzim i vitit aktual.

Tutje, pagesa në vlerë prej 1,468€ është regjistruar si shpenzim, megjithëse në fakt përfaqëson depozitë sigurie lidhur me një kontratë për furnizim me energji elektrike, e cila pritet t'i kthehet kompanisë pas përfundimit të kontratës. Si e tillë, kjo pagesë duhet të trajtohet si pasuri dhe jo si shpenzim.

Këto mangësi kanë ardhur si rezultat i mungesës së trajtimit të duhur të transaksioneve nga kompania, si dhe mungesës së kontrolleve dhe rishikimeve të mjaftueshme për të siguruar klasifikimin dhe regjistrimin e saktë të tyre në periudhat përkatëse.

#### **Ndikimi**

Mos prezantimi i saktë i shpenzimeve ka ndikuar që ato të raportohen jo drejt në pasqyrën e të ardhurave. Po ashtu, trajtimi i gabuar i disa transaksioneve ka ndikuar edhe në pasqyrën e pozitës financiare, duke mos paraqitur saktë pasuritë, përkatësisht parapagimet dhe depozitat.

#### **Rekomandimi B8**

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që kompania të bëjë rishikim të plotë të klasifikimit të transaksioneve, me qëllim që shpenzimet të regjistrohen në periudhat përkatëse dhe në përputhje me natyrën e tyre. Po ashtu, duhet të sigurohet identifikimi dhe trajtimi i saktë i parapagimeve dhe depozitave si pasuri, si dhe të vendoset kontroll i veçantë mbi transaksionet e fundvitit dhe harmonizimi i shënimeve kontabël me pasqyrat financiare.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B9 - Nënvlerësimi i obligimeve për shkak të mos regjistrimit të faturave në periudhën përkatëse**

##### **Gjetja**

Ligji Nr. 06/L- 032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Neni 12 Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

Kompania kishte prezantuar llogaritë e pagueshme tregtare në shumë prej 73,957€. Gjatë auditimit, përmes rishikimit të dokumentacionit burimor (faturave hyrëse dhe evidencave përcjellëse), janë identifikuar dy fatura në vlerë totale prej 12,879€, të cilat i përkasin periudhës raportuese, por nuk janë regjistruar në regjistrin e llogarive të pagueshme. Si rrjedhojë, obligimet e kompanisë në fund të periudhës janë paraqitur më të ulëta se sa gjendja reale.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mungesës së procedurave dhe kontrolleve për regjistrimin në kohë të faturave, si dhe mungesës së rishikimit të detyrimeve të pashlyera para përgatitjes dhe miratimit të pasqyrave financiare. Po ashtu, mungesa e barazimeve me furnitorë dhe komunikimit të duhur ndërmjet njësive operative dhe financave ka ndikuar që këto obligime të mos identifikohen dhe regjistrohen me kohë.

**Ndikimi** Mungesa e përfshirjes së llogarive të pagueshme në regjistrin përkatës ka ndikuar që obligimet e kompanisë të raportohen të nënvlerësuar në pasqyrat financiare.

**Rekomandimi B9** Bordi i Drejtorëve duhet të hartoj një procedurë për regjistrimin e faturave dhe të forcohet kontrolli i brendshme duke përcaktuar përgjegjësia e qartë e stafit dhe të sigurohet monitorim i rregullt në procesin e raportimit.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A1 - Mospërputhje e vlerës së shpenzimeve të pagave ndërmjet vlerave të prezantuara në shënimet kontabël dhe atyre të paraqitura në pasqyrat financiare.**

**Gjetja** SNK1 - paraqitja e pasqyrave financiare, në nenin 15 përcakton se pasqyrat financiare do të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në kuadrin konceptual për raportimin financiar.

Kompania në pasqyrat financiare kishte raportuar shpenzimet e pagave në vlerë prej 1,387,989€, ndërsa sipas të dhënave të deklaruara në ATK kjo vlerë ishte 1,394,256€, duke rezultuar me një diferencë prej 6,267€. Gjatë auditimit është konstatuar se kjo diferencë është si rezultat i pasaktësive në paraqitjen e shpenzimeve të pagave në pasqyrat financiare, ndërsa vlera e deklaruar në ATK paraqet gjendjen e saktë.

Kjo diferencë ka ardhur si rezultat i pasaktësive në përgatitjen e pasqyrave financiare, përkatësisht gjatë përmbledhjes dhe transferimit të të dhënave të pagave nga evidencat përkatëse në PFV, duke mos reflektuar plotësisht vlerat e deklaruara në ATK.

**Ndikimi** Mospërputhja në raportimin e shpenzimeve të pagave ka ndikuar që ky zë të mos paraqitet plotësisht i saktë në pasqyrat financiare.

**Rekomandimi A1** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që kompania të bëjë harmonizimin e të dhënave të pagave ndërmjet pasqyrave financiare dhe deklarimeve në ATK para finalizimit të pasqyrave financiare, me qëllim me qëllim sigurimin e paraqitjes së saktë të tyre.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B10 - Trajtim dhe prezantim i pasaktë i të hyrave në sistemin kontabël dhe pasqyrat financiare****Gjetja**

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 1 (SNK) Paraqitja e Pasqyrave Financiare, në nenin 15 përcakton se pasqyrat financiare do të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në Kuadrin Konceptual për raportimin financiar.

Të hyrat sipas shënimeve kontabël ishin 2,345,879€, ndërsa në pasqyrat financiare 2,171,650€, me një diferencë prej 174,229€. Sipas sqarimeve të kompanisë, kjo diferencë ka ardhur si rezultat i mënyrës së gjenerimit të të dhënave nga sistemi kontabël, i cili i paraqet të hyrat nga amvisëria me TVSH, ndërsa në pasqyrat financiare ato janë prezantuar pa TVSH.

Megjithëse vlera e të hyrave në pasqyrat financiare për këtë vit është paraqitur drejt sa i përket TVSH-së, kjo është arritur përmes korigjimeve manuale. Vlen të theksohet se ky problem është evidentuar vetëm te të hyrat nga amvisëria, ndërsa të hyrat nga bizneset dhe institucionet gjenerohen saktë nga sistemi. Kjo çështje ishte adresuar edhe në vitin e kaluar, mirëpo edhe në vitin aktual nuk janë bërë rregullimet e nevojshme në sistemin kontabël.

Tutje, gjatë analizës së mostrave dhe regjistrimit të të hyrave, janë identifikuar edhe mangësi të tjera si në vijim:

- Korigjimet që i përkasin viteve të kaluara në vlerë prej 25,985€ janë reflektuar si zvogëlim i të hyrave të vitit aktual, megjithëse ato do të duhej të trajtoheshin si korigjime të fitimit të mbajtur dhe të mos ndikonin në rezultatin e vitit aktual;
- Kthimi i akontacioneve të mbajtura në paga në vlerë prej 3,550€ është trajtuar si zvogëlim i të hyrave, megjithëse nuk i përket kësaj kategorie;
- Në vitin aktual janë faturuar dhe përfshirë në të hyra shërbime që i përkasin viteve paraprake (2022, 2023 dhe 2024) në vlerë prej 3,497€, megjithëse ato do të duhej të njiheshin në periudhat përkatëse.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së shënimeve të klasifikuara sipas standardit nga sistemi kontabël. Gjithashtu, mungesa e rishikimit të duhur nga menaxhmenti ka ndikuar që të bëhen trajtime të pasakta kontabël.

**Ndikimi**

Kjo situatë ka ardhur si rrjedhojë e mos përshtatjes së sistemit kontabël me kërkesat dhe politikat kontabël për paraqitjen e të hyrave, si dhe mungesës së rishikimit cilësor nga menaxhmenti financiar para miratimit të pasqyrave financiare. Po ashtu, mungesa e kontrolleve të mjaftueshme ka ndikuar që të hyrat të mos regjistrohen dhe paraqiten sipas natyrës dhe periudhës së duhur.

**Rekomandimi B10** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që sistemi kontabël të jetë i harmonizuar me politikat kontabël dhe standardet përkatëse, si dhe të vendosen kontrole efektive në mënyrë që të hyrat të regjistrohen dhe prezantohen të saktë në pasqyrat financiare.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A2 - Zhvillimi i dy procedurave të prokurimit për të njëjtin lloj furnizimi

#### Gjetja

Neni 16 i Ligjit për Prokurimin Publik thekson se autoriteti kontraktues nuk do të zgjedh ose përdor metodën e vlerësimit me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në nenin 19 për klasifikimin e kontratës publike sipas vlerës së parashikuar; dhe asnjë autoritet kontraktues, nuk do të ndajë kërkesën për prokurim për një sasi të caktuar të produkteve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në nenin 19 të këtij ligji.

Në planin e prokurimit për vitin 2025, kompania kishte paraparë zhvillimin e procedurës “Furnizim me pjesë për automjete” me vlerë të parashikuar 300,000€. Megjithatë, gjatë vitit ka zhvilluar dy procedura të ndara prokurimi për të njëjtin furnizim, si në vijim:

- Më datë 15.04.2025 është nënshkruar kontratë kornizë për “Furnizim me pjesë për automjete” në vlerë indikative prej 135,191€.
- Ndërsa më datë 15.09.2025 është nënshkruar një tjetër kontratë për furnizime të natyrës së njëjtë në vlerë prej 149,729€.

Vlen të ceket se në të dy procedurat, kontratat janë nënshkruar me të njëjtin operator ekonomik.

Kjo kishte ndodhur për shkak të planifikimit jo të duhur të nevojave nga e njëjta njësi kërkuese, e cila nuk kishte përfshirë në mënyrë të plotë kërkesat për furnizim.

#### Ndikimi

Zhvillimi i dy procedurave të ndara për të njëjtin furnizim cenon parimet e transparencës dhe konkurrencës në prokurim, duke krijuar rrezik për ndarje të kërkesës dhe shmangie të procedurave të rregullta. Si rrjedhojë, kjo ndikon në integritetin e procesit të prokurimit dhe mund të ketë kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, duke mos siguruar kushtet më të favorshme për kompaninë.

#### Rekomandimi A2

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që njësitë kërkuese të bëjnë paraprakisht vlerësimet e duhura të nevojave për furnizime dhe që plani i prokurimit të konsolidohet duke grupuar kërkesat e natyrës së njëjtë, në mënyrë që të shmanget ndarja e tyre në procedura të veçanta.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja A3 - Miratimi dhe pagesa e bonusit për anëtarët e Bordit në kundërshtim me kornizën ligjore****Gjetja**

Ligji nr.04/L-111 për ndryshim plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, neni 12 paragrafi 2 përcakton se NP është përgjegjëse për pagimin e të gjithë kompensimit për drejtorët e saj vetëm nga pagesat e parapara me Vendimin e Aksionarit. Drejtorët e NP nuk do të marrin asnjë kompensim ose përfitim tjetër nga NP. Ndërsa në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se kufizimi i kompensimit për stimulimin e performancës vjetore (nëse ka) e që përcaktohet pas auditimit të pasqyrave financiare dhe publikimit të raporteve mbi performancën nga zyrat rregullatorë. Ky kompensim-bonus u paguhet drejtorëve, në një shumë deri në pesëdhjetë përqind (50%) e honorarit themelor.

Bordi i Drejtorëve, më datë 05.06.2026, kishte nxjerrë vendim për kompensim të anëtarëve të tij, të arsyetuar me performancën e kompanisë gjatë vitit 2024, përkatësisht me rezultatet e raportit të auditimit. Vlera e kompensimit ishte 5,760€ në total (1,920€ për secilin anëtar). Megjithatë, për këtë vendim Bordi i Drejtorëve nuk kishte marrë aprovim paraprak nga Aksionari, siç kërkohet nga korniza ligjore për ndërmarrjet publike.

Për më tepër, kompania kishte opinion të kundërt në raportin e auditimit për vitin 2024, çka tregon se performanca e saj nuk ka qenë e kënaqshme dhe, rrjedhimisht, nuk mund të konsiderohet si bazë e arsyeshme për shpërblimin e performancës.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore që rregullojnë kompensimin e anëtarëve të bordit dhe mungesës së mbikëqyrjes adekuate nga aksionari në lidhje me miratimin e kompensimeve dhe përfitimeve për anëtarët e bordit.

**Ndikimi**

Miratimi dhe pagesa e kompensimeve për anëtarët e bordit pa bazë të qartë ligjore dhe pa aprovimin e aksionarit përbën përdorim jo të rregullt të fondeve publike dhe cenon parimin e llogaridhënies dhe transparencës në ndërmarrjet publike.

**Rekomandimi A3**

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të mos ndërmerren vendime për kompensime apo pagesa të ngjashme për anëtarët e bordit pa miratim paraprak nga aksionari dhe pa bazë të qartë ligjore. Po ashtu, duhet të sigurohet që çdo vendimmarrje të jetë në përputhje me kompetencat e përcaktuara dhe kornizën ligjore në fuqi.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B11 - Mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm****Gjetja**

Sipas Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, neni 4, pikat 1.1 deri 1.9, përcakton se udhëheqësi i subjektit të sektorit publik, në këtë rast Bordi, ka përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, politikave, strategjive, programeve, aktiviteteve dhe proceseve që ndërlidhen me zbatimin e tyre. Po ashtu, sipas Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 31.1 përcakton se brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, zyrtarët e ndërmarrjes publike duhet të përgatisin dhe dorëzojnë në Bordin e Drejtorëve raportin tremujor për periudhën përkatëse ndërsa sipas pikës 31.3, brenda 45 ditëve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, zyrtarët e ndërmarrjes publike duhet të përgatisin dhe dorëzojnë raportin vjetor për vitin e sapo përfunduar, i cili përfshin përshkrimin e veprimeve të ndërmarra, rezultatet financiare dhe nivelin e realizimit të objektivave të përcaktuara në Planin e Biznesit ndërsa, brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit vjetor, Bordi i Drejtorëve është i obliguar ta shqyrtojë, ndryshojë sipas nevojës, ta miratojë dhe ta dorëzojë atë në Njësinë për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike për publikim, si dhe, sipas rastit, në Qeveri apo në Komisionet Komunale të Aksionarëve, si dhe të sigurojë publikimin e tij në faqen zyrtare të ndërmarrjes.

Kompania nuk ka të vendosur në mënyrë të duhur sistemin e kontrollit të brendshëm. Mangësitë e identifikuar janë si në vijim:

- Kompania gjatë vitit 2025 nuk kishte funksional Komitetin e Auditimit dhe ende nuk kishte rekrutuar auditor të brendshëm;
- Nuk ka rregullore për menaxhimin e pasurisë, rregullore për përshkrimin e vendeve të punës dhe përcaktimin e gradës për secilën pozitë, rregullore për menaxhimin e të hyrave dhe të arkëtueshmeve, si dhe listë me përshkrimin e proceseve dhe kodin e etikës të azhurnuar nga viti 2009;
- Nuk ka një regjistër të rreziqeve dhe politikë për menaxhimin e rrezikut;
- Gjatë vitit ishte miratuar vetëm raporti i tremujorit të tretë (TM3), ndërsa raportet e tjera tremujore dhe raporti vjetor nuk ishin miratuar në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara në nenin 31 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve konkrete nga Bordi Drejtues për vendosjen e një sistemi adekuat të kontrollit të brendshëm, si dhe për shkak të mosmbajtjes së rregullt të mbledhjeve gjatë vitit, çka ka ndikuar që raportet tremujore dhe raporti vjetor të mos shqyrtohen dhe miratohen brenda afateve të përcaktuara ligjore.

**Ndikimi** Mungesa e auditorit të brendshëm për vite me radhë, si dhe mangësitë e tjera të përshkruara më lart, dobësojnë sistemin e kontrollit të brendshëm dhe kufizojnë mbikëqyrjen e pavarur mbi proceset financiare dhe operative. Si pasojë, rritet rreziku që parregullsitë dhe gabimet të mos identifikohen me kohë. Po ashtu, mosmiratimi i raporteve tremujore dhe vjetore zvogëlon transparencën dhe kufizon monitorimin e performancës dhe vendimmarrjen e informuar.

**Rekomandimi B11** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për funksionalizimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, si dhe për azhurnimin dhe plotësimin e politikave, procedurave dhe rregulloreve për administrimin dhe funksionimin e kompanisë, përfshirë përgatitjen e listës së proceseve dhe regjistrit të rreziqeve. Po ashtu, Bordi duhet të sigurojë mbajtjen e rregullt të mbledhjeve dhe shqyrtimin e miratimit në kohë të raporteve tremujore dhe vjetore, në përputhje me kërkesat ligjore.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B12 - Pagesa për pensionistët jo në harmoni me kërkesat ligjore**

**Gjetja** Ligji nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, Neni 6. Mbledhja e kontributeve për financimin e pensioneve të kursimeve individuale, 6.1 Çdo punëdhënës është i obliguar që të kontribuojë në emër të punonjësve të vet në Fondin e kursimeve pensionale. Punonjësit obligohen që të kontribuojnë në emër të vet në kursimet pensionale. Po ashtu, pika 6.3 kërkohet që punëdhënësi të zbrit kontributin pensional të punonjësve nga rrogat e punonjësve dhe të bartë në llogarinë e posaçme të fondit bashkë me kontributin e punëdhënësit në afatin e duhur në përputhje me rregullat që do të nxirren në mënyrën që e cakton Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).

Gjatë vitit 2025, kompania kishte realizuar pagesa në vlerën 42,063€ në emër të kontributeve pensionale për punonjës që tashmë kanë dalë në pension. Këto pagesa janë realizuar drejtpërdrejt ndaj ish-punonjësve tashmë të pensionuar, dhe jo ndaj Trustit Pensional, me qëllim kompensimin e detyrimeve të pa përmbushura nga vitet e mëparshme, për periodha gjatë të cilave kompania nuk kishte transferuar kontributet në Trustin Pensional të Kosovës, ndonëse ato ishin mbajtur nga pagat e punonjësve dhe ishin deklaruar në periodhat përkatëse.

Për me tepër, pagesat e drejtpërdrejta ndaj të punësuarve të pensionuar, nuk zvogëlojnë obligimin ligjor të ndërmarrjes për transferimin e kontributeve në llogaritë e Trustit, dhe nuk kanë efekt në uljen e detyrimeve zyrtare të ndërmarrjes ndaj këtij institucioni. Vlen të theksohet se vlera totale e detyrimeve për kontributet pensionale, të cilat janë mbajtur nga pagat e punonjësve por nuk janë transferuar në llogaritë e tyre personale në Trust, arrin shumën 1,919,516€.

Kjo situatë ka ardhur si rrjedhojë e mungesës së mjeteve financiare për mbulimin e detyrimeve ndaj Trustit Pensional, si dhe akumulimit të borxheve ndër vite, të cilat nuk janë shlyer në kohë nga kompania.

**Ndikimi** Mos pagesa e detyrimeve për kontribute pensionale, ka ndikim në depozitat kursimore në Trustin Pensional të Kosovës, rrjedhimisht edhe në pagesën e pensioneve më të vogla për punëtorët kur pensionohen.

**Rekomandimi B12** Bordi i Drejtorëve duhet të realizojë një analizë të plotë të të gjitha kontributeve të papaguara ndaj Trustit Pensional si dhe të rishikoj mundësitë që detyrimet ndaj trustit pensional të paguhen në baza të rregullta në mënyrë që të mos paraqitet nevoja e pagesave direkte të pensioneve ndaj të punësuarve.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B13 - Regjistri i pasurisë jo në përputhje me rregulloren e kompanisë**

**Gjetja** Sipas nenit 14, të Rregullores për Zbatimin e Procedurave dhe Politikave Afariste, kompania është e obliguar që të ketë regjistër të detajuar të pasurive fikse, cili mbahet në softuerin e kontabilitetit dhe duhet të përmbajë këto elemente: numrin rendor të pasurive, emri i pasurisë, emrin e kompanisë nga e cila është blerë, numrin inventarizues, njësinë e kompanisë ku është vendosur, datën e blerjes, kostoja historike, grupi zhvlerësues në përqindje, zhvlerësimi i vitit të tanishëm dhe zhvlerësimi i akumuluar, vlera neto kumulative sipas grupeve të pasurive.

Kompania nuk ka përgatitur regjistrin e pasurive afatgjata sipas kërkesave të rregullores për zbatimin e procedurave dhe politikave afariste, si: data e blerjes, grupi i zhvlerësimit në përqindje dhe numri inventarizues. Për më tepër, pasuritë nuk mbahen në softuer të kontabilitetit, por në Excel, dhe një pjesë e pasurisë është regjistruar në grup dhe jo artikull për artikull (p.sh. kompjuterë 20 copë, printerë 4 copë, karrika 29 copë, tavolina 29 copë, etj.).

Kjo situatë ka ardhur si rrjedhojë e mungesës së një sistemi të integruar për menaxhimin e pasurive si dhe mungesës së përgjegjësive të qarta për regjistrimin dhe përditësimin e regjistrit të pasurive.

**Ndikimi** Mungesa e regjistrit të plotë për menaxhimin e pasurisë ndikon që pasuritë të mos trajtohen në mënyrën e duhur dhe rrjedhimisht kjo ndikon në prezantimin jo të saktë të pasurive në pasqyrat financiare.

**Rekomandimi B13** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që kompania të bëjë plotësimin e regjistrit ekzistues të pasurive në përputhje me kërkesat e rregullores, duke përfshirë të gjitha elementet përkatëse. Po ashtu, duhet të sigurohet që regjistri të mbahet në softuerin e kontabilitetit, që pasuritë të regjistrohen në mënyrë individuale dhe të ndërmerren veprime konkrete për zbatimin e këtyre kërkesave në një afat të arsyeshëm.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B14 - Përdorimi i shpeshtë i blerjeve me vlera të vogla (nën 100€)****Gjetja**

Paragrafi 6 i nenit 29 të Rregullës Financiare nr. 01/2013/MF- Shpenzimi i Parave Publike kërkon që “Paratë e imëta nuk mund të shfrytëzohen për të gjitha shpenzimet që mund të bëhen praktikisht përmes procesit të rregullt të shpenzimeve”. Ndërsa në nenin 21 të kësaj rregulle përcaktohet që shpenzimet që nuk kërkojnë prokurim janë: pagat, shpenzimet e paguara me para e imët, avancat për udhëtime, komunalit, subvencionet dhe transferet dhe transaksionet ndërdepartamentale.

Kompania kishte realizuar pagesa në vlerë totale prej 11,162€ për furnizime dhe shërbime të ndryshme, përmes parasë së gatshme dhe pagesave bankare, pa ndjekur procedurat e parapara të prokurimit dhe pa dokumentacion justifikues për aplikimin e ndonjë përjashtimi ligjor. Këto pagesa lidhen kryesisht me mirëmbajtje dhe servisime të automjeteve, si dhe nevoja të tjera operative.

Po ashtu, në tetë raste është identifikuar ndarja e faturave për furnizime të natyrës së njëjtë, duke i shpërndarë ato në vlera më të vogla, çka ka rezultuar në mos aplikim të procedurave të rregullta të prokurimit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së planifikimit të duhur të nevojave për furnizim dhe dobësive në kontrollet e brendshme.

**Ndikimi**

Realizimi i pagesave ndaj operatorëve ekonomik pa ndjekur procedurat e prokurimit cenon parimet e transparencës dhe konkurrencës, si dhe anashkalon kontrollin formal të prokurimit. Si rrjedhojë, kjo rrit rrezikun e favorizimit të operatorëve të caktuar dhe dobëson trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, dhe duke rritur rrezikun e blerjeve me çmime jo të favorshme për kompaninë.

**Rekomandimi B14**

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që praktikat e pagesave pa ndjekur procedurat e prokurimit, të ndalen. Gjithashtu, duhet të sigurojë që çdo blerje e kësaj natyre të realizohet vetëm në raste të arsyetuara, të nevojshme dhe të mbështetet me dokumentacion përkatës, duke parandaluar njëkohësisht ndarjen e faturave dhe duke forcuar kontrollet e brendshme.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja C1 - Mos pagesa e punonjësve me gradë të njëjtë për pozitën e njëjtë****Gjetja**

Sipas Ligjit të Punës, Nr.03/L-212, neni 55 specifikohet se punëdhënësi duhet t'i paguajë punonjësit kompensimin e njëjtë për punën e vlerës së njëjtë, kompensimin i cili mbulon pagën bazë dhe shtesat tjera.

Gjatë testimit të listës së pagave, kemi identifikuar se për gjashtë pozita të njëjta, punonjësit nuk paguhen me grada ose nivele të barabarta, pavarësisht se kryejnë të njëjtat detyra dhe kanë përshkrim të njëjtë të pozitës. Rastet e tilla i referohen pozitave si menaxher njësie, kryepunëtor, zyrtar personeli, automekanik, furnizues, vozitës etj.

Megjithëse gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë disa rregullime për pozita të caktuara, pagesat e ndryshme për pozitat e njëjta kanë ardhur si rezultat i mungesës së hartimit të një politike të unifikuar për kategorizimin dhe shpërblimin e punonjësve.

#### **Ndikimi**

Pagesa e punonjësve për pozita të njëjta me grada të ndryshme cenon parimin e barazisë së trajtimit në marrëdhënie pune dhe ndikon negativisht në motivimin e stafit. Po ashtu, kjo situatë mund të rezultojë në ankesa apo padi nga punonjësit, duke krijuar kosto shtesë për ndërmarrjen.

#### **Rekomandimi C1**

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që kompania të bëjë një analizë të plotë të strukturës së pagave, me qëllim identifikimin e dallimeve për pozitat e njëjta dhe harmonizimin e gradave për këto pozita. Po ashtu, duhet të vendoset një qasje e qartë dhe e dokumentuar për kategorizimin dhe shpërblimin e punonjësve, në mënyrë që të sigurohet trajtim i barabartë dhe i qëndrueshëm.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja C2 - Mospërputhje ndërmjet gjendjes së pasurive sipas inventarizimit dhe regjistrave kontabël, si dhe mungesa e veprimeve për trajtimin e tyre**

##### **Gjetja**

Sipas Ligjit Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12, Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Inventarizimi i pasurive dhe detyrimeve kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi drejtues i shoqërive tregtare dhe duhet të barazohet me librat kontabël.

Në fund të vitit, kompania ka formuar komisionin për inventarizimin e pasurive, i cili me datë 09.01.2026 kishte dorëzuar raportin e inventarizimit. Në këtë raport, pasuritë janë evidentuar në mënyrë individuale, përfshirë edhe ato në gjendje të dëmtuar apo jashtë përdorimit, duke shënuar përmirësim krahasuar me vitin paraprak.

Megjithatë, kemi konstatuar se komisioni nuk kishte realizuar një inventarizim të plotë të të gjitha pasurive, pasi 19 automjete të regjistruara në librat kontabël nuk janë përfshirë fare në procesin e inventarizimit dhe për to nuk janë dhënë sqarime lidhur me gjendjen apo arsyet e mosverifikimit.

Tutje, ndonëse komisioni kishte identifikuar disa pasuri si jashtë përdorimi dhe kishte rekomanduar krijimin e një komisioni përkatës për trajtimin e tyre, ndërmarrja nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim në këtë drejtim. Si rrjedhojë, çështjet e identifikuara nga komisioni nuk janë harmonizuar me regjistrin e pasurive dhe nuk janë reflektuar në pasqyrat financiare.

Mangësitë e identifikuara ishin si rrjedhojë e moszbatimit të plotë të procedurave të inventarizimit nga komisioni përkatës, si dhe mungesës së mbikëqyrjes efektive dhe veprimeve konkrete nga menaxhmenti për trajtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të dala nga procesi i inventarizimit.

**Ndikimi** Mos harmonizimi i gjendjes faktike të pasurive me regjistrat kontabël ul nivelin e sigurisë mbi ekzistencën e tyre në momentin e inventarizimit. Kjo mund të rezultojë në prezantim dhe shpalosje të pasaktë të pasurive në pasqyrat financiare, duke rritur rrezikun për gabime dhe duke cenuar besueshmërinë e raportimit financiar.

**Rekomandimi C2** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që komisioni i inventarizimit të realizojë një verifikim të plotë të të gjitha pasurive të regjistruara në libra dhe që për çdo pasuri të paverifikuar të jepen sqarime dhe të ndërmerren veprime përkatëse. Po ashtu, të siguroj që të zbatohen në kohë rekomandimet e komisionit për trajtimin e pasurive jashtë përdorimi, duke siguruar që rezultatet e inventarizimit të harmonizohen me regjistrat kontabël dhe të reflektohen në pasqyrat financiare.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

#### Çështja B15 - Gabime në regjistrim të transaksioneve

##### Gjetja

SNK 1 në paragrafin 13, përcakton se pasqyrat financiare duhet të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon paraqitje besnike të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të dhëna në kuadrin konceptual. Ndërsa, neni 3 i Rregullores së Brendshme për Zbatimin e Procedurave dhe Politikave afariste përcakton që faturimi për klientët e amvisërisë bëhet nga data 01-04 të çdo muaji, për shërbimin e bërë në muajin paraprak sipas tarifave fikse të aprovuara dhe vlen për dy komunat në të cilat operon kompania.

Gjatë analizimit të llogarive të arkëtueshme, të pagueshme dhe të hyrave, janë identifikuar gabime dhe parregullsi në regjistrimin dhe trajtimin e transaksioneve, si në vijim:

- Nga testimi i mostrave për llogaritë e arkëtueshme, në 45 raste janë identifikuar gabime në trajtimin kontabël të pagesave ndaj furnitorëve në vlerë totale prej 30,460€. Këto pagesa janë klasifikuar gabimisht si llogari të arkëtueshme, në vend që të njiheshin si shpenzime të ndërmarrjes;
- Në regjistrin e llogarive të pagueshme figuron vlera prej 6,921€ si detyrime ndaj klientëve që kanë parapaguar kompaninë në vitet paraprake, të cilët në vitin 2025 nuk janë më klientë të kompanisë. Konkretisht, janë identifikuar 238 klientë në vlerë prej 3,555€ nga njësia në Mitrovicë (jo klientë që nga viti 2017), si dhe 257 klientë në vlerë prej 3,366€ nga njësia në Vushtrri (jo klientë që nga viti 2024). Ndërmarrja nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për korrigjimin, kthimin apo shlyerjen e këtyre detyrimeve;
- Gjithashtu janë evidentuar parregullsi në procesin e faturimit, përfshirë mosfaturim të klientëve për vitin 2025 dhe mungesë faturimi për muaj të caktuar pa sqarime përkatëse, vazhdim të faturimit si për klientë rezidentë edhe pas ndryshimit të statusit në jo-rezident duke rezultuar në faturim të dyfishtë, vazhdim të faturimit edhe pas rrënimit të objektit, si dhe mospërputhje në numrin e faturimeve ndërmjet kartelave të klientëve dhe shënimeve analitike.

Gabimet në regjistrimin e transaksioneve janë shkaktuar si rezultat i mangësive në procedurat kontabël dhe kontrollin e transaksioneve.

- Ndikimi** Këto mangësi në regjistrimin dhe trajtimin e transaksioneve ndikojnë në prezantim jo të saktë dhe jo të plotë të pasqyrave financiare, duke rezultuar në keqklasifikim të zërave (si llogari të arkëtueshme, të pagueshme, shpenzime ) dhe në mbivlerësim apo nënvlerësim të tyre. Po ashtu, parregullsitë në procesin e faturimit ndikojnë drejtpërdrejt në saktësinë dhe plotësinë e të hyrave, ndërsa mungesa e veprimeve ndaj detyrimeve të vjetra rrit rrezikun e gabimeve materiale, duke ulur besueshmërinë e informacionit financiar dhe duke ndikuar në vendimmarrje jo të duhur nga menaxhmenti dhe palët e interesuara.
- Rekomandimi B15** Bordi i Drejtorëve, për të parandaluar gabimet e ngjashme në të ardhmen, duhet të sigurojë se janë forcuar procedurat e kontrollit të brendshëm lidhur me trajtimin e saktë të transaksioneve financiare.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3.2 Stoqet

Vlera e stoqeve e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar ishte 31,268€. Ky zë financiar kryesisht përfshinë materiale, pjesë rezervë, vaj dhe naftë të cilat janë kryesisht të lidhura me funksionimin e kompanisë.

### Çështja B16 - Prezantimi jo i saktë i stoqeve në pasqyra financiare

**Gjetja** SNK 2-Inventarët në pikën 28 përcakton që kosto e inventarëve mund të mos jetë e rikuperueshme kur inventarët dëmtohen, janë bërë tërësisht ose pjesërisht të vjetërsuar ose nëse çmimet e shitjes së tyre kanë rënë. Kosto e inventarëve mund të mos jetë e rikuperueshme nëse janë rritur kostot e çmuara të përfundimit ose kostot e çmuara që duhet të kryhen për realizimin e shitjes. Praktika e zhvlerësimit të inventarëve poshtë kostos deri në vlerën neto të realizueshme është në koherencë me pikëpamjen që pasuritë nuk duhet të mbahen me shuma mbi ato që pritet të realizohen nga shitja apo përdorimi i tyre.

Gjatë testimit të stoqeve kemi vërejtur se kompania ka të regjistruara si stoqe katër pajisje në vlerë totale prej 7,271€ (makinë për goma, makinë bore, gjenerator dhe multikultivator bore), të cilat sipas zyrtarëve përdoren herë pas here për nevoja të kompanisë. Megjithatë, për këto pajisje kompania nuk kishte bërë dalje zyrtare nga depoja, nuk kishte aplikuar normë amortizimi, si dhe nuk ishte rishikuar vlera e tyre që nga viti 2013.

Mungesa e regjistrimeve të duhura në vitet e mëhershme dhe mos rishikimi i hollësishëm i regjistrit të stoqeve ndër vite ishte shkak i prezantimit jo të duhur në pasqyra financiare.

**Ndikimi** Mos aplikimi i zhvlerësimit dhe mos rishikimi i vlerës së pajisjeve që janë në përdorim për një periudhë të gjatë kohore ka ndikuar në pasqyrimin jo të saktë të vlerës së stoqeve dhe, rrjedhimisht, edhe të shpenzimeve në pasqyrat financiare.

**Rekomandimi B16** Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj se bëhet rishikim i rregullt i gjendjes së pajisjeve dhe të sigurojë që ato të klasifikohen saktë kur kalojnë në përdorim. Po ashtu, duhet të aplikohet zhvlerësimi sipas afatit të shërbimit të secilës pajisje, në përputhje me standardet kontabël, në mënyrë që pasqyrat financiare të pasqyrojnë vlerat reale të pasurisë dhe shpenzimeve të kompanisë.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.3 Detyrimet afatshkurta

Vlera neto e zërit financiar të detyrimeve afatshkurtra e prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare ishte € 3,980,160€. Brenda këtij zëri janë prezantuar llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera 73,957€ dhe detyrimet e tjera afatshkurtra 3,906,203€.

#### Çështja B17 - Prezantimi i llogarive të pagueshme të paidentifikuara

**Gjetja** SNK1, paraqitja e pasqyrave financiare, në nenin 15 përcakton se pasqyrat financiare do të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në kuadrin konceptual për raportimin financiar.

Gjatë procesit të auditimit kemi vërejtur se arkëtimet në vlerë prej 20,442€, prej të cilave 2,576€ i përkasin vitit 2025, nuk janë zbritur nga obligimet e konsumatorëve përkatës ndaj kompanisë, por vazhdonin të figuronin në regjistrin e llogarive të pagueshme me përshkrimin “Blerës i pa identifikuar”.

Kjo kishte ndodhur për shkak të pamundësisë për identifikimin e klientëve përmes llogarisë bankare të kompanisë, si rezultat i përshkrimeve jo të plota ose jo të sakta të të dhënave gjatë kryerjes së pagesave, si dhe për shkak të mungesës së përpjekjeve të mjaftueshme nga ana e kompanisë për të identifikuar dhe sistemuar këto pagesa.

**Ndikimi** Mos identifikimi i saktë i pagesave nga ana e klientëve rrit rrezikun që klientët të ngarkohen padrejtësisht me obligime të cilat veç i kanë paguar apo t'i dekurajojë që të mos paguajnë obligimet e tyre në të ardhmen. Rrjedhimisht kjo mund të ndikoj edhe në nivelin e uljes së inkasimeve.

**Rekomandimi B17** Bordi i Drejtorëve të sigurojë që janë marrë veprimet e duhura për të identifikuar klientët të cilët i kanë kryer pagesat e grumbulluara në llogarinë “Blerës i paidentifikuar ” dhe se klientëve të identifikuar, u janë zbritur obligimet e papaguara ndaj kompanisë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.4 Shpenzimet e pagave

Shpenzimet e pagave për vitin 2025 janë prezantuar në pasqyrat financiare 1,457,388€. Më 31 dhjetor 2025, numri i të punësuarve ishte 210, ndërsa në vitin 2024 ishin 211.

#### Çështja B18 - Akontacionet e dhëna punëtorëve pa ndonjë bazë të qartë ligjore

##### Gjetja

Neni 3 i Kodit të Sjelljes dhe Etikës të kompanisë thekson se, çdo punëtor i kompanisë realizon të ardhura, paga dhe shtesa të tjera lidhur me pagën konform kontratës së punës apo vendimit të organit kompetent, andaj çdo përvetësim në forma të tjera konsiderohet i paligjshëm.

Në evidencat kontabël të kompanisë figuron një shumë prej 34,710€ e cila përfaqëson paradhënie page (akontacione) të dhëna punëtorëve në vitet e kaluara. Edhe pse më 19 nëntor 2018 është marrë vendim për kthimin e këtyre mjeteve përmes ndalesës në paga, deri në fund të vitit 2025 vlera e prezantuar mbetet e pakthyer.

Në periudhën kur janë dhënë këto mjete, kompania nuk ka pasur rregullore të shkruar që të përcaktojë kriteret për marrjen e akontacioneve, shumën maksimale të lejuar, afatet e kthimit apo mënyrën e zbatimit të ndalesave në paga. Aktualisht, kompania është e përfshirë në procese gjyqësore me disa punëtorë, të cilët nuk i kanë kthyer këto mjete.

Kjo kishte ndodh për shkak se kompania e kishte konsideruar të arsyeshme që punëtorëve në raste të caktuara t'u japë mjete financiare në formë avanci me qëllim të kthimit apo zbatimit në pagat e ardhshme të punonjësve. Kompania në planin e veprimit kishte potencuar se është në proces të kthimit të akontacioneve, ndonëse është evidentuar progres për kthimin e tyre, ne kemi vërejtur se kthimi i mjeteve nuk ishte bërë në tërësi.

##### Ndikimi

Pa mundësia e kthimit të akontacioneve ndikon në potencialin financiar dhe zhvillimin e kompanisë.

##### Rekomandimi B18

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të respektohet vendimi i kthimit të akontacioneve/avanseve në paga nga punëtorët deri në mbledhjen totale të tyre, si dhe të nxirren politika të qarta lidhur me mundësinë e pagesave të tilla nga ana e kompanisë.


#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të KRM Uniteti sh.a., ka rezultuar në 26 rekomandime kryesore. Entiteti kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, gjashtë rekomandime ishin zbatuar, 17 nuk janë zbatuar ende dhe tre rekomandime ishin zbatuar pjesërisht, siç është paraqitur në Grafikon 1, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 1 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se do këtë komunikim të duhur në mes të drejtorive përkatëse dhe që të merren veprimet e nevojshme për trajtimin e çështjeve të identifikuara, duke forcuar kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive, në mënyrë që ato të pasqyrohen drejtë në pasqyrat financiare.	Nuk është implementuar, pasi edhe në vitin aktual janë evidentuar mangësi në komunikimin ndërmjet drejtorive dhe në menaxhimin e pasurive, duke ndikuar në pasqyrimin jo të saktë të tyre në pasqyrat financiare.	Nuk është adresuar

2.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të bëhen analiza gjithëpërfshirëse në lidhje me aftësinë e pagesës së borxheve nga konsumatorët dhe të bëhet provizionimi i llogarive të arkëtueshme Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK).	Rekomandimi mbetet i paimplementuar. Bordi i Drejtorëve nuk ka siguruar kryerjen e analizave gjithëpërfshirëse lidhur me aftësinë paguese të konsumatorëve dhe nuk ka siguruar provizionimin e llogarive të arkëtueshme në përputhje me SNK. Kjo çështje është trajtuar edhe në raportet e mëparshme, por ende nuk është adresuar.	Nuk është adresuar
3.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që është bërë regjistrimi i saktë dhe i plotë i granteve me qëllim të prezantimit të saktë të të hyrave të shtyra dhe atyre të fituara nga zhvlerësim i granteve në mënyrë që të rritet besueshmëria e raportimeve ndaj vendimmarrësve, donatoreve dhe palëve të jashtme.	Nuk është implementuar, pasi edhe në vitin aktual janë evidentuar mangësi në regjistrimin dhe prezantimin e saktë të granteve.	
4.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj, se të ndryshimet e bëra në zërat e pasqyrave financiare përfshirë korigjimin retrospektiv të të dhënave të jenë të mbështetura me dokumente relevante dhe se do ipen sqarime të qarta në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për çdo ndryshim që ndikon në kapitalin e kompanisë në përputhje me standardet përkatëse. Gjithashtu, të sigurojë trajnime për stafin financiar dhe të forcojë kontrollet e brendshme lidhur me përgatitjen, rishikimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.	Nuk është implementuar, pasi edhe në vitin aktual janë evidentuar ndryshime në zërat e pasqyrave financiare pa dokumentacion mbështetës	Nuk është adresuar
5.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që detyrimet tatimore të kompanisë të harmonizohen me gjendjen e llogarive në ATK dhe të prezantohen saktë në pasqyrat financiare vjetore.	Nuk është implementuar, pasi edhe në vitin aktual janë evidentuar mospërputhje dhe mosdeklarim i saktë i vlerës së detyrimeve tatimore.	Nuk është adresuar

6.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë funksionimin e duhur të kontrolleve dhe se do behet një analizë gjithëpërfshirëse të zërave të cilët kanë ndikuar në mos prezantimin e saktë të rrjedhës së parasë dhe të marrë veprimet e nevojshme korrigjuese për të pasur një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.	Nuk është implementuar, pasi edhe në vitin aktual janë identifikuar gabime të ngjashme në prezantimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë.	Nuk është adresuar
7.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që kompania të bëjë një rishikim të kujdesshëm të klasifikimeve të kodeve për shpenzimet dhe kostos së mallit të shitur përpara përgatitjes së pasqyrave financiare, për të shmangur mbivlerësime të tilla në të ardhmen.	Nuk është implementuar, pasi edhe në vitin aktual janë evidentuar mospërputhje ndërmjet shënimeve kontabël dhe pasqyrave financiare për kategorinë e shpenzimeve.	Nuk është adresuar
8.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që programi i kontabilitetit që përdorë kompania të jetë në harmoni me politikat e saj kontabël në mënyrë që prezantimi i të hyrave të jetë i saktë në pasqyra financiare.	Rekomandimi mbetet pjesërisht i implementuar. Edhe pse gjatë vitit 2025 janë bërë korrigjime në pasqyrat financiare duke prezantuar të hyrat pa TVSH në mënyrë manuale, programi i kontabilitetit ende nuk është në harmoni me politikat kontabël të kompanisë, pasi në sistem të hyrat vazhdojnë të figurojnë me TVSH. Kjo situatë rrit rrezikun e pasqyrit jo të saktë dhe kërkon ndërhyrje për zgjidhje sistimore.	Pjesërisht i zbatuar

9.	Baza për opinion	Bordi i Drejtoreshë të sigurojë se do të bëhet një rishikim i detajuar i regjistrit të llogarive të arkëtueshme si dhe do rishikohet funksionimi i programit të kontabilitetit. Po ashtu, duhet të forcohet bashkëpunimi ndërmjet departamentit financiar dhe njësive të tjera, të përmirësohen procedurat e pasqyrit dhe të kryhet verifikim i rregullt i të dhënave. Trajnimi i stafit financiar mbetet thelbësor për përdorimin korrekt të sistemit dhe për shmangien e gabimeve të ngjashme në të ardhmen.	Nuk janë identifikuar mospërputhje ndërmjet regjistrit të llogarive të arkëtueshme dhe vlerës së prezantuar në pasqyrat financiare	I zbatuar
10.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se para çertifikimit të pasqyrave financiare, ato i nënshtrohen një procesi të rishikimit të hollësishëm në mënyrë që prezantimi i pasurisë afatgjatë, të jetë i saktë dhe i plotë. Të implementohet një proces i automatizuar për kalkulimin e zhvlerësimit, në mënyrë që të minimizohet mundësia e gabimeve teknike që mund të ndodhin gjatë përpunimit manual të të dhënave.	Në vitin 2025 nuk janë evidentuar mospërputhje ndërmjet vlerës së pasurive sipas regjistrit dhe pasqyrave financiare.	I zbatuar
11.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të forcohen kontrollet e brendshme në mënyrë që kriteret e vendosura në konkurse të jenë në përputhje me kërkesat e brendshme rregullative.	Është implementuar, pasi në vitin 2025 nuk janë identifikuar raste të mospërputhjes së kriterëve të konkurseve me kërkesat e brendshme rregullative.	I zbatuar
12.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve duhet të realizojë një analizë të plotë të të gjitha kontributeve të papaguara ndaj Trustit Pensional si dhe të rishikoj mundësitë që detyrimet ndaj trustit pensional të paguhen në baza të rregullta në mënyrë që të mos paraqitet nevoja e pagesave direkte të pensioneve ndaj të punësuarve.	Nuk është implementuar, pasi edhe në vitin aktual detyrimet ndaj Trustit Pensional nuk janë trajtuar në mënyrë të plotë dhe nuk janë paguar në baza të rregullta.	Nuk është adresuar

13.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që procesi i inventarizimit të bëhet në mënyrë të rregullt dhe para dorëzimit të pasqyrave financiare, në mënyrë që rezultatet e regjistrimeve të fundvitit të harmonizohen me regjistrat kontabël dhe diferencat eventuale të reflektohen edhe në pasqyra financiare.	Pjesërisht i implementuar, pasi janë vërejtur përmirësime në procesin e inventarizimit, duke evidentuar pasuritë në mënyrë individuale. Megjithatë, ende nuk janë përfshirë disa automjete në inventarizim dhe nuk janë dhënë sqarime për to, si dhe nuk janë ndërmarrë veprime për trajtimin e mungesave dhe pasurive jashtë përdorimit.	Pjesërisht i zbatuar
14.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se praktikatat e tilla të blerjeve direkte përmes fondit të parave të imta duhet të ndalen. Po ashtu, Bordi duhet të sigurojë se blerjet e kësaj natyre bëhen vetëm kur janë të arsyetuara dhe të nevojshme.	Nuk është implementuar, pasi edhe në vitin aktual janë evidentuar praktikat e blerjeve direkte pa arsyetim të mjaftueshëm.	Nuk është adresuar
15.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të ofrohen shpjegime të plota dhe transparente për çdo ndryshim retrospektiv që ndikon në fitimin e mbajtur, duke siguruar përputhshmëri me kërkesat e standardeve. Gjithashtu, duhet të dokumentohen të gjitha korrigjimet për periudhat e mëparshme, përfshirë shkaqet, ndikimin financiar dhe vendimet përkatëse. Për më tepër, është e nevojshme të forcohet kontrolli i brendshëm në procesin e rishikimit të pasqyrave financiare.	Është implementuar, pasi në vitin aktual nuk janë hasur ndryshime retrospektive në zërin e fitimit të mbajtur.	I zbatuar
16.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Bordi i Drejtorëve, për të parandaluar gabimet e ngjashme në të ardhmen, duhet të sigurojë se janë forcuar procedurat e kontrollit të brendshëm lidhur me trajtimin e saktë të transaksioneve financiare.	Nuk është implementuar, pasi edhe në vitin aktual nuk janë ndërmarrë veprime për forcimin e procedurave të kontrollit të brendshëm lidhur me trajtimin e transaksioneve financiare.	Nuk është adresuar

17.	Llogaritë e arkëtueshme	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë, që të bëhet një vlerësim i saktë i regjistrit të llogarive të arkëtueshme, barazimet periodike me klientë si dhe të sigurojë dëshmitë përkatëse para aprovimit të pasqyrave financiare. Gjithashtu, duhet të krijohet një plan për inkasimin e borxheve, të identifikojë klientët me borxhe të vjetra dhe të ndërmarrë veprime ligjore për mbledhjen e tyre.	Rekomandimi mbetet i paimplementuar. Bordi i Drejtorëve nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të siguruar vlerësimin e saktë të regjistrit të llogarive të arkëtueshme, realizimin e barazimeve periodike me klientët dhe sigurimin e dëshmive përkatëse para aprovimit të pasqyrave financiare. Po ashtu, nuk është hartuar asnjë plan për inkasimin e borxheve, nuk janë identifikuar klientët me borxhe të vjetra dhe nuk janë ndërmarrë veprime ligjore për mbledhjen e tyre. Si rezultat, rastet e keq prezentimit janë rritur më tej krahasuar me periudhën e mëparshme.	Nuk është adresuar
18.	Stoqet	Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj se bëhet rishikim i rregullt i gjendjes së pajisjeve dhe të sigurojë që ato të klasifikohen saktë kur kalojnë në përdorim. Po ashtu, duhet të aplikohet zhvlerësimi sipas afatit të shërbimit të secilës pajisje, në përputhje me standardet kontabël, në mënyrë që pasqyrat financiare të pasqyrojnë vlerat reale të pasurisë dhe shpenzimeve të kompanisë.	Nuk është implementuar, pasi edhe në vitin aktual janë evidentuar mangësi në rishikimin dhe klasifikimin e stoqeve, si dhe në aplikimin e zhvlerësimit të tyre, duke ndikuar në paraqitjen e saktë të vlerës së stoqeve në pasqyrat financiare.	Nuk është adresuar

19.	Pasuritë afatgjata	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që është hartuar një regjistër i brendshëm për menaxhimin e pasurive i cili i përmban të gjitha elementet të cilat kërkohen me rregulloren e brendshme.	Rekomandimi mbetet i paimplementuar dhe çështja, ndonëse e trajtuar edhe në raportet e mëparshme, vazhdon të mos adresohet nga Bordi i Drejtorëve.	Nuk është adresuar
20.	Detyrimet afatshkurta	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se regjistrat e kontabilitet janë të saktë dhe të plotë dhe komunikimi dhe shkëmbimi i informatave mes sektorëve në ndërmarrje të jetë në nivelin e duhur.	Nuk është implementuar, pasi çështja nuk është adresuar në vitin aktual.	Nuk është adresuar
21.	Detyrimet afatshkurta	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që janë marrë veprimet e duhura për të identifikuar klientët të cilët i kanë kryer pagesat e grumbulluara në llogarinë “Blerës i paidentifikuar ” dhe se klientëve të identifikuar, u janë zbritur obligimet e papaguara ndaj kompanisë.	Nuk është implementuar, pasi edhe në vitin aktual nuk janë ndërmarrë veprime të mjaftueshme për identifikimin e klientëve dhe për zbritjen e obligimeve përkatëse.	Nuk është adresuar
22.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtorëve të sigurojë se aplikimi i kriterëve përkatëse bëhet në harmoni të plotë me kërkesat ligjore në mënyrë që të rekomandohen për kontratë OE që kanë kapacitetet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës.	Është implementuar, pasi në vitin aktual nuk janë identifikuar raste të ngjashme lidhur me moszbatimin e kriterëve ligjore gjatë vlerësimit të operatorëve ekonomikë.	I zbatuar
23.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se do bëhet trajnimi i duhur i stafit për zbatimin e sistemit në menaxhimin e kontratave dhe se janë eliminuar të gjitha pengesat të cilat kanë ndikuar në mos zbatimin e kërkesave ligjore si dhe të sigurojë menjëherë fillimin e përdorimit të moduleve të e-prokurimit për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës.	Është implementuar, pasi në vitin 2025 është përdorur sistemi i e-prokurimit për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës.	I zbatuar

24.	Shpenzimet e pagave	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të respektohet vendimi i kthimit të akontacioneve/avanseve në paga nga punëtorët deri në mbledhjen totale të tyre, si dhe të nxirren politika të qarta lidhur me mundësinë e pagesave të tilla nga ana e kompanisë.	Nuk është implementuar, pasi edhe në vitin aktual nuk janë ndërmarrë veprime për respektimin e kthimit të akontacioneve/avanseve në paga dhe nuk janë hartuar politika të qarta lidhur me këto pagesa.	Nuk është adresuar
25.	Shpenzimet e pagave	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë, që përmes akteve të brendshme të fuqizojë kontrollet e brendshme, të cilat do të pamundësojnë që punonjësit në pozitat e njëjta të paguhen me grada të ndryshme.	Pjesërisht i implementuar, pasi edhe pse janë bërë disa korrigjime, ende nuk është siguruar zbatim i plotë dhe vazhdojnë të ekzistojnë raste të pagesave me grada të ndryshme për pozita të njëjta.	Pjesërisht i zbatuar
26.	Funksioni i auditimit të brendshëm	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që të funksionalizohet Njësia e Auditimit të Brendshëm, të azhurnohen dhe lotësohen politikat, procedurat dhe rregulloret për administrimin dhe funksionimin e ndërmarrjes, të përgatitet lista e proceseve dhe regjistri i rreziqeve.	Rekomandimi mbetet i paimplementuar. Bordi i Drejtorëve nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për funksionalizimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, azhurnimin dhe plotësimin e politikave, procedurave dhe rregulloreve për administrimin dhe funksionimin e ndërmarrjes, si dhe për përgatitjen e listës së proceseve dhe regjistrit të rreziqeve.	Nuk është adresuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit



Shpresa Zenelaj, Udhëheqëse e ekipit



Mimoza Morina, Anëtare e ekipit



Kaltrina Neziri, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

## Leterkonfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATUMI PËRMBAJTJES DATE OF CONTENT: 23			
Niveli Org. Org. Unit	Shifri Klasif. Classif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages
05	44	604	1

Kompania Regionale e Mbeturimeve	
KRM	UNITETI-SH.A
Nr. Prot.	184 KE
Data	21-04-2026 Mitrovicë



## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të "KRM Uniteti" sh. a., për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem/ nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Liridon Hajdini

Kryesues i Bordit të "UNITETI" sh. a.,

Data: 20.04.2026



## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- <sup>2</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

**KRM "Uniteti" SH.A. – Mitrovicë**  
**Pasqyrat Financiare për vitin 2025**

Mitrovicë, Prill 2026



Kompania: KRM "UNITETI" SH.A

Numri Unik Identifikues : 810547911

Komuna: Mitrovicë

**Pasqyrat Financiare**

**Periudha Raportuese : 01.01.2025 – 31.12.2025**

Përmbajtja:

- 1.Pasqyra e Fitimit (Humbjes) dhe të Ardhurave tjera Gjithpërfshirëse
- 2.Pasqyra e Pozicionit Financiar
- 3.Pasqyra e Rrjedhës së Parasë
- 4.Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet
- 5.Shpalosjet

Përpiloi:

Znj.Ermira Delija Rexha

Zyrtare Kryesore Financiare dhe e Thesarit

**Pasqyra e Fitimit/(Humbjes) dhe të Ardhurave tjera Gjithëpërfshirëse - SNK 1**  
**Periudha raportuese 01.01.2025 - 31.12.2025**

Zërat Financiar	Shënimet	2025	2024
<u>Të ardhurat nga shitjet</u>	<u>1</u>	2,171,650.98	€ 2,168,901.48
<u>Kostoja e shitjes</u>	<u>2</u>	(123,107.42)	€ (187,735.43)
<b><u>Fitimi bruto</u></b>		<b><u>2,048,543.56</u></b>	<b><u>€ 1,981,166.05</u></b>
<u>Të ardhurat tjera</u>	<u>3</u>	151,559.77	€ 151,559.77
<u>Shpenzimet e pagave</u>		(1,387,989.06)	€ (1,321,036.12)
<u>Shpenzimet e kontributeve pensionale</u>		(69,399.45)	€ (66,051.81)
<u>Shpenzimet e derivateve</u>		(206,464.80)	€ (221,460.06)
<u>Shpenzimet e telefonisë</u>		(4,134.46)	€ (4,472.81)
<u>Shpenzimet e internetit</u>		(679.98)	€ (812.05)
<u>Shpenzimet e ujit</u>		(424.64)	€ (553.13)
<u>Shpenzimet e logjistikës</u>	<u>4</u>	(23,302.13)	€ (30,106.62)
<u>Shpenzimet e rrymës</u>		(5,241.34)	€ (3,452.11)
<u>Shpenzimet e zyrës</u>	<u>5</u>	(16,225.75)	€ (25,281.89)
<u>Shpenzimet e reprezentacionit</u>	<u>6</u>	(1,139.27)	€ (3,659.49)
<u>Shpenzimet e qirave</u>		(12,264.00)	€ (12,065.93)
<u>Shpenzimet e provizionit bankar</u>		(2,899.53)	€ (2,280.31)
<u>Shpenzimet e zhvlerësimit</u>	<u>7</u>	(398,077.15)	€ (397,314.99)
<u>Shpenzimet e ndihmave të bamirësisë</u>	<u>8</u>	(961.90)	€ (1,342.10)
<u>Shpenzimet e marketingut</u>		(900.00)	€ (2,137.00)
<u>Shpenzimet e tatimit në pronë</u>		-	€ (334.33)
<u>Shpenzimet e borxheve të parikuperuesh</u>	<u>9</u>	(7,335.52)	
<b><u>Fitimi operativ</u></b>		<b><u>€ 62,664.35</u></b>	<b><u>€ 40,365.07</u></b>
<u>Të ardhurat financiare</u>		€ -	€ -
<u>Shpenzimet e financimit</u>		€ -	€ -
<u>Fitimi/Humbja nga shitja e aseteve</u>		€ -	€ -
<b><u>Fitimi para tatimit</u></b>		<b><u>€ 62,664.35</u></b>	<b><u>€ 40,365.07</u></b>
<u>Tatimi në fitim TAK</u>		€ (6,266.43)	€ -
<b><u>Fitimi Neto i periudhës</u></b>		<b><u>€ 56,397.91</u></b>	<b><u>€ 40,365.07</u></b>
<u>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse</u>		€ -	€ -
<b><u>Gjithsej të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse</u></b>		<b><u>€ 56,397.91</u></b>	<b><u>€ 40,365.07</u></b>

Vesa Broja  
 Kryeshefe Ekzekutive

*Broja*

Përpiloi: Ermira Delija Rexha  
 Zyrtare Kryesore Financiare dhe Thesarit

*Delija Rexha*

Granit Maxhuni/ ID : 1053  
 Kontablist i Certifikuar

*Granit Maxhuni*




**Pasqyra e Pozicionit Financiar - SNK 1**


Për vitin që mbaron më 31.12.2025

<b>Zërat financiar</b>	<b>2025</b>	<b>2024</b>
<b>Pasuritë</b>		
<b>Pasuritë afatgjata :</b>		
Mjetet dhe Pajisjet	€ 517,491.73	€ 895,900.86
Ndërtesat	€ 356,250.00	€ 380,000.00
Toka	€ 1,378,000.00	€ 1,378,000.00
	<b>€ 2,251,741.73</b>	<b>€ 2,653,900.86</b>
<b>Pasuritë afatshkurtëra :</b>		
Stoqet	€ 31,268.20	€ 41,103.10
Të arkëtueshmet tregtare	€ 4,161,172.25	€ 4,050,289.31
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	€ 6,324.39	€ 7,341.31
	<b>€ 4,198,764.84</b>	<b>€ 4,098,733.72</b>
<b>Gjithsej Pasuritë</b>	<b>€ 6,450,506.57</b>	<b>€ 6,752,634.58</b>
<b>Ekuiteti dhe Detyrimet</b>		
<b>Detyrimet afatgjata :</b>		
Të ardhurat e shtyera nga grantet	€ 303,119.54	€ 454,679.32
	<b>€ 303,119.54</b>	<b>€ 454,679.32</b>
<b>Detyrimet afatshkurtëra :</b>		
Të pagueshmet tregtare	€ 73,957.45	€ 269,298.96
Detyrimi ndaj tatimi në paga	€ 682,825.57	€ 618,125.96
Detyrimi ndaj tatimi mbi vlerën e shtuar	€ 1,289,799.26	€ 1,272,938.97
Detyrimi ndaj kontributeve pensionale të punëtorit	€ 829,626.42	€ 783,806.37
Detyrimi ndaj kontributeve pensionale të punëdhënësit	€ 829,626.42	€ 783,806.37
Detyrimi ndaj tatimi mbi qiratë	€ 695.61	€ 99.34
Detyrimi ndaj tatimit ne fitim TAK	€ 273,630.52	€ 253,043.16
	<b>€ 3,980,161.25</b>	<b>€ 3,981,119.13</b>
<b>Ekuiteti :</b>		
Kapitali aksionar i zakonshëm	€ 25,000.00	€ 25,000.00
Fitimi i periudhës	€ 56,397.91	€ 40,365.07
Fitimet e mbajtura	€ 768,170.17	€ 727,805.10
Rezervat tjera	€ 1,317,657.70	€ 1,523,656.96
	<b>€ 2,167,225.78</b>	<b>€ 2,316,827.13</b>
<b>Gjithsej Detyrimet dhe Ekuiteti</b>	<b>€ 6,450,506.57</b>	<b>€ 6,752,625.58</b>

Vesa Broja  
Kryeshefe Ekzekutive




Përpiloi: Ermira Delija Rexha  
Zyrtare Kryesore Financiare dhe Thesarit





Granit Maxhuni/ ID : 1053  
Kontabilist I Çertifikuar




KRM "Uniteti" SH.A.  
Numri Unik Identifikues : 810547911  
Adresa : Vëllezërit Dragaj p.n.  
Komuna : Mitrovicë

PNE - PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET PËR VITIN FISKAL 2025 - PERIUDHA RAPORTUESE : 01.01.2025 - 31.12.2025

NR.	Pëshkrimi	Kapitali Aksionar / Pronarit	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
1	Giendia më 1 Janar 2024	€ 25,000.00	€ 727,805.10	€ 1,523,656.96	€ 2,276,462.06
2	Fitimi / (Humbja) i/e vitit	€ -	€ 40,365.07	€ -	€ 40,365.07
3	Diferencat nga përthimet valutore	€ -	€ -	€ -	€ -
4	Dividendat / Tërheqjet	€ -	€ -	€ -	€ -
5	Deponimet e kapitalit shtesë	€ -	€ -	€ -	€ -
6	Ndarja e rezervave	€ -	€ -	€ -	€ -
7	Giendia më 31 Dhjetor 2024	€ 25,000.00	€ 768,170.17	€ 1,523,656.96	€ 2,316,827.13
8	Fitimi / (Humbja) i/e vitit	€ -	€ 56,397.91	€ -	€ 56,397.91
9	Diferencat nga përthimet valutore	€ -	€ -	€ -	€ -
10	Dividendat / Tërheqjet	€ -	€ -	€ -	€ -
11	Deponimet e kapitalit shtesë	€ -	€ -	€ (205,999.30)	€ (205,999.30)
12	Ndarja e rezervave	€ -	€ -	€ -	€ -
13	Giendia më 31 Dhjetor 2025	€ 25,000.00	€ 824,568.08	€ 1,317,657.66	€ 2,167,225.74

Vesa Broja  
Kryeshefe Ekzekutive  




Përpiloi: Ermira Delija Rexha  
Zyrtare Kryesore Financiare dhe Thesarit  


Granit Maxhuni/ ID : 1053  
Kontabilist/ Çertifikuar



**PASQYRA E RRJEDHAVE TË PARASË PËR VITIN FISKAL 2025 - PERIUDHA RAPORTUESE**

01.01.2025-31.12.2025

NR. Përshkrimi	Shëni 31.12.2025
<b>RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE</b>	
1 Fitimi / (Humbja) e vitit	€ 56,397.91
<b>Rregullimet për zërat jo-monetar të shpenzimeve dhe të të hyrave</b>	
2 Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impijanteve	€ 398,077.15
3 Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	€ -
4 Amortizimi i pasurive të paprekshme	€ -
5 Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme	€ -
6 Ndryshimi i vlerës së pronës investuese	€ -
7 Të ardhurat financiare	€ -
8 Shpenzimet financiare	€ -
9 (Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve	€ -
10 Shpenzimet e tatimit në fitim	€ 6,266.43
	<b>€ 460,741.49</b>
<b>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</b>	
<b>(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare</b>	
11 dhe të tjera	€ (110,882.90)
12 (Rritja) / zvogëlimi në stoke	€ 9,834.90
13 (Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	€ -
14 Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	€ (195,342.00)
15 Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	€ 40,630.89
	<b>€ (255,759.11)</b>
16 Tatimi në fitim i paguar	€ -
17 Interesi i paguar	€ -
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</b>	<b>€ 204,982.38</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>	
18 Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	€ -
19 Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	€ -
20 Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme	€ -
21 Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme	€ -
22 Interesi i arkëtuar	€ -
23 Dividendat e arkëtuara	€ -
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese</b>	<b>€ -</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>	
24 Deponimet e kapitalit shtesë	€ -
25 Dividendat e paguara/Tërheqjet	€ -
26 Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	€ -
27 Ripagimi i kredive dhe huave	€ -
28 Ndryshimet tjera në ekuitet	€ (205,999.30)
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>	<b>€ (205,999.30)</b>
<b>Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë</b>	<b>€ (1,016.92)</b>
29 Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	€ 7,341.31
30 <b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>	<b>€ 6,324.39</b>

Vesa Broja  
Kryeshefe Ekzekutive






Përpiloi: Ermira Delija Rexha  
ZKF



Granit Maxhuni/ ID : 1053  
Kontabilist i Certifikuar



**Kompania : KRM "UNITETI" SH.A.**

**Numri Unik Identifikues : 810547911**

**Komuna : Mitrovicë**

Periudha raportuese : 01.01.2025 – 31.12.2025

Ky dokument paraqitet nga kompania KRM "UNITETI" SH.A. me qëllim të sqarimit të zërave financiar të Pasqyrave Financiare për periudhën raportuese 2025, i emëruar si

## **SHPALOSJE E ZËRAVE TË PASQYRAVE FINANCIARE**

### **Hyrje**

Kompania Rajonale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. është e regjistruar si "Kompani" respektivisht Shoqëri Aksionare e cila është inkorporuar më datën 28.Dhjetor 2007 në Kosovë, sipas projektit për Korporatizimin e Sektorit të Mbeturinave në Kosovë. Kompania është plotësisht në pronësi si Njësi e Kompanisë rajonale të Mbeturinave më tutje (KRM) "Uniteti" Sh.A. dhe njëherit është pasardhëse legale e Kompanisë Publike "Uniteti" Holding– Mitrovicë. Adresa dhe zyra qendrore e Kompanisë është : Rruga "Vilëzrit Dragaj" p.n. – 40 000 Mitrovicë Kosovë. Kapitali fillestar i regjistruar i Kompanisë është 25,000.00 Euro. Librat e Kompanisë janë hapur me 01 janar 2007 bazuar në Pasqyrën e gjendjes Fillestare, pastaj bazuar edhe në Raportin e Studimit Financiar po ashtu edhe të dhënat nga vlerësimi i bërë me 01 janar 2007 nga "Pohl Consulting and Associates"- Berlin, Gjermani ( një projekt i financuar nga Bashkimi Europian (BE) dhe menaxhuar nga Agjensioni Europian për Rindertim (AER), po ashtu edhe vlerësimi i bërë nga Kompania " Bakertilly " L.L.C. në vitin 2021.

Kompania ofron shërbime në mbikqyrjen e mbeturinave për teritoret e Komunave; Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj. Numri mesatar i të punësuarve në Kompani ishte 278

### **1. Politikat e kontabilitetit**

Në vijim janë shpalosur "Politikat themelore të kontabilitetit" të adaptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

#### **1.1 Baza e përgatitjes**

Keto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndrkombetare të Raportimit Financiar (SNRF-të) respektivisht (IFRS-të), Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike, por janë modifikuar për përgatitjen e Pasurive (pronës, ndërtesave dhe paisjeve) ku janë marrë shumat e rivlersueara viti 2021 siq janë theksuar më tejë në këtë shenim.

Këto pasqyra janë përgatitur në pohimin se kompania do të vazhdojë vijueshmërinë (vijimësinë) e aktiviteteve të veta ekonomike për se paku një periudhë afatshkurter dymbdhjetë mujore .

Përgatitja e pasqyrave financiare në pajtim me SNRF-të kërkon përdorimin e parashikimeve kritike të shpeshta për evidencat kontabël dhe kontabilitet. SNRF-të po ashtu kërkojnë nga Menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tyre në proceset e aplikimit të politikave të kontabilitetit. Parashikime janë të bazuara në njohuritë dhe ngjarjet e tanishme dhe veprimet më të mira të menaxhmentit. Rezultatet aktuale edhe mund të jenë të ndryshme nga ato të parashikuara. Këto pasqyra financiare janë përgatitur për vitin ushtrimor që mbaron me 31. Dhjetor 2025. Të gjitha të dhënat janë të paraqitur në euro. Të dhënat krahasuese në gjitha pasqyrat financiare janë të dhënat për vitin ushtrimor që mbaron me 31. Dhjetor 2024.

## **1.2 Adaptimi i Standardeve të reja ose atyre të reviduara**

Ne vitin operues 2025 Kompania ka adaptuar të gjitha Standardet e reja apo ato që janë ndryshuar apo reviduar si dhe gjitha interpretimet e leshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) si dhe nga Komiteti Interpretues Ndërkombëtar për Raportime Financiare (KINRF) që është në kuadër të (BSNK), e të cilat janë të rëndësishme në aktivitetet e sajë, dhe efektive për periudhat raportuese vjetore duke filluar nga: 1 janari i vitit 2025. Adaptimi i Standardeve të reja por edhe atyre të reviduara si dhe Interpretimet nuk kanë rezultuar në ndryshimet e politikave të Kontabilitetit të Kompanisë.

## **1.3 Valuta funksionale dhe prezentim**

"Pasqyra financiare" janë të prezentuara në valutën e euros (€), e cila njëherit është valuta funksionale dhe legale në Republikën e Kosovës dhe përdoret për të gjitha buxhetet, shënimet dhe llogaritë financiare, për të gjitha pagesat përfshirë edhe pagesat e detyrueshme.

## **1.4 Patundshmëritë ndërtesat dhe paisjet**

Zërat e patundshmërive, ndërtesave dhe paisjeve që figurojnë në "Pasqyrën e pozites Financiare" paraqesin shumat e bartura nga rivlerësimet e bazuara viti 2023 në vlerësimin e bërë, korrigjuar me zhvlerësimin e akumuluar që kanë pasuar më pastaj. Efekti i vlerësimit është vendosur në llogarinë e kapitalit aksionar. E gjithë patundshmëria, ndërtesat dhe paisjet tjera që nuk janë përfshirë në vlerësim janë paraqitur sipas kostos historike korrigjuar me zhvlerësimin e akumuluar respektivisht riparimeve thelbësore. Kosto historike paraqet shpenzimin që i atribuohet drejt për drejt blerjes së pasurisë.

Kostot e ndodhura pasuese (blerjet apo riparimet thelbësore) janë përfshirë në vlerën bartëse të mjeteve apo është njohur si mjet i veçant në mënyrë të duhur, vetëm atëher kur fitimi ekonomik i mundshëm lidhur me këtë mjet mund të rrjedhë në Kompani dhe vlera e mjetit mund të matet besueshëm. Të gjitha riparimet tjera dhe mirëmbajtëja ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

## **Zhvlerësimet**

Toka apo patundshmëria nuk është e zhvlerësueshme. Zhvlerësimi në pasuritë tjera është bërë me metodën drejt-vizore për të alokuar kostot e tyre ose shumat e rivlerësuar të vlerave të mbetura mbi jetën e përdorimit të parashikuar siq vijonë:

- Ndërtesat me normën vjetore prej..... 5 %
- Paisjet prodhuese dhe makineria, Automjetet dhe paisjet e zyres ..... 20 %

Vlera e mbetur e pasurive dhe jeta e përdorimit janë rishikua, dhe rregulluar nëse është e nevojshme në secilën datë të bilancit të gjendjes. Vlera bartëse e një pasurie është e shënuar menjëher në vlerën e sajë të rikuperueshme nëse vlera bartëse e pasurisë është më e madhe se sa që është parashikuar vlera e rikuperueshme.

Fitimet ose humbjet kapitale janë përcaktuar nga rrjedha e krahasimit me vlerën bartëse. Këto janë të përfshira rezultatin e vitit ushtrimor si fitim apo humbje e periudhës dhe duhet pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### **1.5 Dëmet e pasurive jo-financiare**

Pasuritë të cilat kanë jetë përdorimit të pa definuar nuk janë subjekt i zhvlerësimit dhe testohen për ç'do vit dëmet e tyre. Pasuritë të cilat janë subjekt zhvlerësimi janë ri-shikuar për dëmet kurdo që ndodhin ato, ose në rrethanat të cilat e shtyejnë që vlera bartëse e tyre nuk mund të rikuperohet. Humbjet nga dëmet janë njohur për vlerën e cila e kalon vlerën e rikuperueshme të vlerës bartëse të pasurisë. Vlera e rikuperimit e një pasurie është më e madhe se vlera fer, kur ka kosto më të vogël për të u shitur se vlera në përdorim. Për qëllime të vlerësimit të dëmeve, pasuritë janë të grupuara në nivelin më të ulët prej nga janë ndaras të identifikuar rrjedhat e parasë (gjenerimi i njësive të parasë). Pasuritë jo financiare të cilat janë dëmtuar janë ri-shikuar për mundësi pezullimi të dëmeve në secilën datë raportimi.

### **1.6 Pasuritë ( mjetetë ) financiare**

Pasuritë ose mjetet financiare klasifikohen si kategoritë vijuese: Mjete financiare në vlerën reale për mes fitimit apo humbjes, avanset, parapagimet, të arkëtueshmet që nuk mbahen për shitje si dhe të arkëtueshmet të gatëshme për shitje. Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i mjeteve financiare varësisht se kur janë siguruar. Menaxhmenti përcakton klasifikimin e mjeteve në njohjen fillestatre të tyre. Gjerë në datën e bilancit të gjendjes Kompania nuk ka pasuri të klasifikuara në kategoritë e vlerës reale për mes fitimit apo humbjes të gatëshme për shitje. Blerjet dhe shitjet e mjeteve njihen në datën e tregëtimit, që është data kur kompania kryenë blerjen apo shitjen e pasurisë. Avanset dhe të arkëtueshmet e Kompanisë përbëhen prej të arketueshmeve tjera dhe tregëtare, si dhe parasë dhe ekuivalentëve të sajë siq pasqyrohen në bilancin e gjendjes.

### **1.7 Të arketueshmet tjera dhe tregëtare**

Të arketueshmet tjera dhe tregëtare njihen në fillim në vlerën e tyre reale dhe parapakisht të matura me koston e amortizimit duke përdorur metoden efektive të interesit, minus provizionet për dëmet.

Provizionet për dëmet e të arketueshmeve tregëtare është vendosur aty ku ka dëshmi të mjaftueshme që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve origjinale të të arketueshmeve. Vështërsitë e mëdha financiare të debitorit, me gjasë që debitori të bankrotoj apo të ri-organizohet financiarisht si dhe mospagesa apo gabimi në pagesa ( që vonohen më tepër se 30 ditë) konsiderohen si indikator që të arketueshmet tregëtare janë dëmtuar. Shuma e provizionit është diferenca në mes pasurive që bartin shumën bartëse dhe vlera prezente e vlerësuar e rrjedhës së parasë së ardhëshme. Pasuritë me maturitet afatshkurtër nuk janë të zbritura. Vlera bartëse e mjeteve zvogëlohet për mes përdorimit të një kontoje për lejim, dhe shumën e humbjes njihet në "Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve" duke il shtuar koston e shitjeve dhe marketingut. Kur një e arketueshme tregëtare është e pa-mbledhëshme shlyhet kundër kontos për lejimet e të arketueshmeve tjera e tregëtare. Paraprakisht kthimi i shumave para se të shlyhen, kreditohen kundrejt shpenzimeve tjera operative në "Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve".

### **1.8 Paraja dhe ekuivalentët e sajë**

Paraja dhe ekuivalentët e sajë pasqyrohen në "Pasqyrën e pozitës Financiare" sipas kostos. Për qëllime të "Pasqyrës së rrjedhjes së parasë" paraja dhe ekuivalentët e sajë përfshijnë paranë e vogël në arkat e Kompanisë si dhe gjitha dispozitat e mbajtura në bankë si dispozita apo plasmane por të pa afatizuara.

### **1.9 Stoqet**

Kompania stoqet ne fillim regjistrohen sipas kostos kushtuese të tyre dhe më vonë kur ato janë të dëmtuara, atëher ato vlersohen sipas neto vlerës tyre të realizueshme nëse neto vlera e realizueshme është më e ulët se sa kostja e tyre. Neto vlera e realizueshme është çmimi i shitjes në rrjedhë të njëjta të biznesit korrigjuar me koston e kompletimit (marketingut dhe shpërndarjes). Kostoja parimisht është përcaktuar në baza të metodës së çmimit mesatar.

### **1.10 Kapitali aksionar (Ekuiteti)**

Kapitali aksionar përbëhet nga vlera reale dhe monetare kontribuar nga aksionerët e Kompanisë. Kapitali aksionar përmbledhë kapitalin themeltar të kompanisë si dhe rezultatet afariste të periudhave të kaluara dhe periudhës ushtrimore korrigjuar me tërhhjekjet e kapitalit ose shpërndarjet e kapitalit, si dhe nga investimet kapitale të pronarit apo aksionerve

### **1.11 Përfitimet e punëtorve dhe kostot e pensioneve**

Kompania kontribon për punëtorët e vetë në planet pas pensionimit siq janë caktuar me legjislacionin Ligji Nr. 04/L-101 Për fondet pensionale të Kosovës se cilit punëtor duhet që ti ndaj nga të ardhurat e veta (paga bruto) së paku 5% të vlerës së pagës edhe Kompania si punëdhënës duhet të kontribon me së paku 5% të vlerës së pagës bruto të punëtorit dhe këtë shumë të e paguej në llogarin e Trustit e Kursimeve Pensional të Kosovës (TKPK) si kontribute pensionale Në pajtim me "Ligjet fiskale" në Kosovë, konkretisht konform Ligjit nr.-06/L-105 "Mbi tatimin në të ardhura korporatave", Kompania duhet të ndalë në burim dhe të paguan tatimin në të ardhura personale për dhe në llogari të të punësuarëve të vetë.

Kontributet pensionale dhe tatimet në të ardhura personale pastaj ngarkohen në të ardhurat brut të stafit dhe paraqiten si shpenzime operative të periudhës konkrete.

### **1.12 Të pagueshmet tregëtare dhe të pagueshmet tjera**

Të pagueshmet tjera dhe tregëtar njihën në vlerën reale dhe më pastaj maten me kostot e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit.

### **1.13 Tatimi në fitim**

Tatimi në fitim është përfshirë në pasqyrat financiare në pajtim me Rregulloret tatimore të cilat në Kosovës janë në fuqi si Ligjit nr.- 06 / L- 105 "Mbi tatimimi ne korporatave" dhe rregulloret tjera plotësuese aktuale, shpenzimi mbi tatimin në fitim për gjatë periudhave të më hershme raportuese por edhe në këtë vitin ushtrimor është përfshirë në "Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve" dhe duhet të përfshin tatimin aktual dhe ndryshimet e tatimit .

### **1.14 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat njihen kur është mundësia e përfitimeve ekonomike lidhur me rrjedhën e transaksioneve të Kompanisë dhe kur shumat e të ardhurave mund të matet me besueshmëri. Shitjet njihen kur pronësia e mallit është transferuar te blerësi. Të ardhurat nga shërbimet e pasqyruara njihen me adresim të kompletimit të fazave, dhe ato mund të matet besueshëm. Faza e kompletimit është e përcaktuar duke u bazuar në analizat e punëve të performuara. Shpenzimet operative dhe shpenzimet tjera njihen në "Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse" në datën e kryerjes së shërbimit, marrjes së përfitimit ose në datën e origjinës.

### **1.15 Grantet Qeveritare**

Grantet nga Qeveria janë njohur me vlerën reale të tyre, ku është një siguri e arsyeshme që grantet do të mirren si dhe Kompania do të i përmbush gjitha kushtet e parapara për përfitim të grantit e të cilat i janë bashkangjitur grantit.

Grantet Qeveritare që lidhen me kostot, ku kostot janë të shtyera dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse mbi periudhën e domosdoshme që t'i përshtat ato me kostot të cilat janë menduar të kompenzohen.

Grantet Qeveritare që lidhen me blerjen e patundshmërive, ndërtesave apo paisjeve janë të përfshira në detyrime jo qarkulluese si "Grant Qeveritar i shtyrë" dhe janë kredituar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në baza drejt-vizore sipër jetës së prititur për pasuritë e lidhura (blera me grante).

### **1.16 Provizionet**

Provizioni njihet kur Kompania ka një obligim të tanishëm si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe mundësia është që një rrjedhë e burimeve të i shoqëroj beneficionet ekonomike që do të jenë të kërkuara të vendoset obligimi. Provizionet janë rishikuar në ç'do datë të bilancit të gjendjes dhe janë rregulluar ashtu që të reflektoj parashikimet më të mira të tanishme. Kur ndikimi i

vlerës në kohë të parasë është materiale, shuma e provizionit është vlera e tanishme e shpenzimeve të pritura që do të kërkohen të vendosen obligimet.

### **1.17 Pasuritë dhe detyrimet kontigjente**

Pasuria kontigjente është ç'do pasuri e mundëshme që rrjedhë nga ngjarjet e së kaluarës dhe egzistenca e së cilës do të vërtetohet vetëm nga ndodhja ose mos ndodhja e një apo më shumë ngjarjeve të pa sigurta në të ardhëmen, dhe e cila nuk është në tërsi në kontrollin e entitetit. Këto pasuri mund të fitohen vetëm pas të jenë fituar nga kontestet e ndryshme gjyqsore.

Detyrimet kontigjente është ç'do detyrim i mundshëm që rrjedh nga ngjarjet e së kaluarës dhe egzistenca e të cilës do të vërtetohet vetëm nga ndodhja ose mosndodhja e një apo më shumë ngjarjeve të pa sigurta në të ardhëmen dhe e cila nuk është në tërsi në kontrollin e entitetit. Detyrimet e tilla mund të lindin vetëm pas humbjeve të kontesteve gjyqësore. Për detyrimet kontigjente entiteti duhet të ndaj provizione.

### **1.18 Ngjarjet pasuese (pas datës së bilancit)**

Ngjarjet pas përfundimit të vitit raportues në bilancin e gjendëjes, dhe të cilat japin informacione shtesë për pozitën e Kompanisë në datën e bilancit të gjendëjes (ngjarjet rregulluese) janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat nuk janë të rregulluara janë shpalosur në shenimet plotësuese gjithëher kur ngjarja reflekton vlera materiale.

## **2. Menaxhimi i rrezikut financiar**

Rreziku i Menaxhmentit të Kompanisë bartet nga Bordi i Drejtorve. Rreziku i menaxhmentit është i fokusuar në pa-parashikueshmërinë e tregjeve dhe mundohet që të i minimizoj efektet e kundërta mbi performancën biznisore të Kompanisë.

### **3.2. Rreziku i kapitalit**

Objektivat e Kompanisë kur menaxhon me kapital janë që ta ruajnë mundësinë që Kompania të vazhdoj si me punë në mënyrë që të siguroj kthime për aksioneret dhe përfitime për aksioneret tjerë, dhe të mirëmbaj një strukturë optimale të kapitalit që të ulë koston e kapitalit. Në mënyrë të mirëmbajtëjes apo korigjimit të strukturës së kapitalit, Kompania mund të rrisë apo kthej kapitalin te aksioneret apo ti shes pasuritë për ti ulur detyrimet.

### **3.3. Vlerësimi i vlerës reale**

Të arketueshmet tjera dhe tregëtare të Kompanisë, pasuritë likuide si dhe detyrimet tjera dhe tregëtare që kanë maturitet të shkurtër, si pasojë vlera e tyre korrespondon me vlerën reale të tyre. Një gjë e tillë nuk mund të thuhet për pasuritë jo likuide dhe detyrimet afat-gjata ku vlera e tyre reale nuk mund të përcaktohet dhe të parshikohet në perspektive.

## **4. Patundshmëritë, Ndërtesat dhe paisjet**

Në pasqyrën e bilancit të gjendjes patundshmëritë, ndërtesat dhe paisjet janë të paraqitura me vlerën neto të mbetur në libra për pasuritë jo-qarkulluese.

	Vlera bazë për zhvlerëzim	Shkalla e zhvlerësi mi vjetor %	Zhvlerësimi linear 2025	Zhvlerësimi i akumuluar më 31.12.2024	VNL më 31.12.2025
Kamionët dhe mjetet - Mitrovicë	€ 797,793.52	20%	€ 148,728.19	€ 420,113.52	€ 228,951.81
Kamionet dhe mjetet - Vushtrri	€ 588,860.87	20%	€ 117,772.17	€ 324,014.84	€ 147,073.86
Kamionet dhe mjetet - Skenderaj	€ 494,100.00	20%	€ 98,820.00	€ 276,782.71	€ 118,497.29
Mjetet e rënda - Mitrovicë	€ 27,553.90	10%	€ 2,755.39	€ 9,066.17	€ 15,732.34
Pajisjet e zyrës - Mitrovicë	€ 27,940.25	20%	€ 3,505.85	€ 11,253.14	€ 13,181.26
Pajisjet e zyrës - Vushtrri	€ 1,275.00	20%	€ 255.00	€ 1,020.00	€ -
Pajisjet e zyrës - Skenderaj	€ 2,830.00	20%	€ 566.00	€ 2,264.00	€ -
Ndërtesat - Mitrovicë	€ 345,000.00	5%	€ 17,250.00	€ 69,000.00	€ 258,750.00
Ndërtesat - Skenderaj	€ 130,000.00	5%	€ 6,500.00	€ 26,000.00	€ 97,500.00
			€ -		
Tokat - Vushtrri	€ 719,000.00	0%	€ -	€ -	€ 719,000.00
Tokat - Skenderaj	€ 659,000.00	0%	€ -	€ -	€ 659,000.00
	<b>€ 3,793,353.54</b>		<b>€ 396,152.60</b>	<b>€ 1,139,514.38</b>	<b>€ 2,257,686.56</b>

Nga tabela e mësipërme kemi paraqitur zhvlerësimin e aseteve 2025 sipas metodës lineare, duke respektuar kërkesat nga SNK 16 – Pronat, Impijantet dhe Pajisjet, si dhe kërkesat nga Legjislacioni në fuqi në Republiket e Kosoves, mbi kategorizimin e aseteve dhe shkallët për zhvlerësim.

#### . Stoqet

Ne stoqe Kompania i mbanë kryesisht pjesët rezervë dhe lëndet tjera që nevoiten në aktivitetet e Kompanisë

Përshkrimi	31.Dhjetor 2025
Stoqet ne Depo – Mitrovicë	<b>31,268.20€</b>
Gjithseit:	<b>31,268.20€</b>

#### 5. Llogaritë e Arkëtueshme dhe Arkëtimet 2025

Kompania ka llogari te arkëtueshme të larta si shkak i akumulimit ndër vite, të cilat janë të dyshimta në aspektin e mundësisë së arkëtimit, mirëpo kompania ende nuk ka një politikë të

provizionimit të borxheve të parikuperueshme si dhe lejimit të të arkëtueshmeve, andaj ato si të tilla janë paraqitur ashtu sic janë edhe në softuer të kompanisë i cili poashtu është shumë i amortizuar.

## 7. Kapitali themelues dhe dhe kapitali aksionar

### Kapitali aksionar:

Kompania është e regjistruar në Regjistrin e Organizatave Biznesore dhe Tregëtare të Kosovës me datën 01. Dhjetor 2007. Sipas të dhënave nga dosja e regjistrit, kapitali aksionar i Kompanisë kap shumën prej 25,000.00 Euro. Kompania është plotësisht njësi në pronësi të Kompanisë Rajonale të mbeturinave – KRM "Uniteti" Sh.A.

## 8. SNK 8 – Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet dhe Gabimet.

### Rezervat tjera

Në periudhën raportuese 2024, zëri *Rezervat tjera* është rritur artificialisht si rezultat i një gabimi (jo i qëllimshëm) gjatë kalkulimeve, duke rezultuar në një mbivlerësim prej 205,999.26 €.

Në përputhje me kërkesat e SNK 8, si dhe rekomandimet e auditorit ligjor, gjatë kësaj periudhe është bërë korrigjimi i këtij gabimi duke rikthyer vlerën e rezervave në nivelin e saktë prej 1,317,657.70 €.

Hyrjet kontabël (hyrjet e dyfishta):

Dr Rezervat tjera .....	205,999.26 €
Cr Rregullimet në ekuitet .....	205,999.26 €

Paraqitja në pasqyrat financiare:

Saldo e *Rezervave tjera* më 31.12.2025 paraqitet në shumën prej: 1,317,657.70 €

## 9. Shpenzimet operative sipas kategorive

Gjatë periudhës raportuese, shpenzimet operative të ndërmarrjes janë klasifikuar dhe paraqitur sipas natyrës së tyre, në përputhje me kërkesat e raportimit financiar. Këto shpenzime përfshijnë kostot e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, shpenzimet logjistike si dhe shpenzimet administrative të zyrës.

### 1. Kosto e shërbimeve

Kostoja e shërbimeve përfshin të gjitha shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve kryesore të ndërmarrjes. Këto kosto janë të domosdoshme për funksionimin operacional dhe mirëmbajtjen e kapaciteteve të punës.

**Struktura e këtyre kostove është si vijon:**

Pjesë rezervë, materiale harxhuese dhe mirëmbajtje ..... 95,584.80 €  
Vajra ..... 17,098.89 €  
Mbulimi i deponisë ..... 10,423.73 €

Totali i kostos së shërbimeve: 123,107.42 €

Këto shpenzime reflektojnë angazhimin e ndërmarrjes për të siguruar vazhdimësinë e operacioneve, funksionimin teknik të pajisjeve dhe përmbushjen e obligimeve ndaj mjedisit dhe rregullatorëve (p.sh. menaxhimi i deponive).

### 3. Logjistika

Shpenzimet logjistike përfshijnë kostot që lidhen me mbështetjen e operacioneve përmes përdorimit dhe administrimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës.

#### **Përbërja e tyre është:**

Autogomat ..... 10,153.35 €  
Regjistrimet e automjeteve ..... 13,148.78 €

Totali i shpenzimeve logjistike: 23,302.13 €

Këto kosto janë të lidhura drejtpërdrejt me mirëmbajtjen e flotës së automjeteve dhe sigurimin e përputhshmërisë ligjore për përdorimin e tyre në operacione.

### 4. Shpenzimet e zyrës

Shpenzimet e zyrës përfshijnë kostot administrative dhe mbështetëse, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me prodhimin e shërbimeve, por janë të nevojshme për funksionimin e përgjithshëm të ndërmarrjes.

#### **Struktura është si më poshtë:**

Shpenzime administrative ..... 6,984.91 €  
Taksat përmbartimore ..... 7,983.47 €  
Materiale higjienike ..... 1,257.37 €

Totali i shpenzimeve të zyrës: 16,225.75 €

Këto shpenzime përfaqësojnë kostot e menaxhimit administrativ, përmbushjes së obligimeve ligjore dhe mirëmbajtjes së kushteve të punës në ambientet e zyrës.

#### **Përmbledhje**

Totali i shpenzimeve operative të paraqitura më sipër reflekton strukturën funksionale të kostove të ndërmarrjes dhe është në përputhje me parimin e paraqitjes sipas natyrës së shpenzimeve. Kjo ndarje mundëson transparencë më të lartë dhe analizë më të saktë të efikasitetit operacional.